



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:172614

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05505521

P.nr.1097/2020 (2020:186771)

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ -Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Adem Shabani, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në lëndën penale kundër të akuzuarit T.L., me vendbanim në Ferizaj Lagjia “ I. ”, i akuzuar për veprën penale Mashtrim nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së dhe të akuzuarit F.Sh., me vendbanim në fshatin ... rruga “ ... ” nr....., i akuzuar për veprën penale Mashtrim nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1010/20, të datës 29.12.2020, pas mbajtjes së seancës së shqyrtime kryesore me datën 30.12.2021 dhe vazhduar me datat 18.05.2022, dt. 09.06.2022, dt. 26.07.2022, 20.09.2022, dt.02.10.2023, dt.02.11.2023,dt.21.11.2023,me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të akuzës Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, të akuzuarit T.L., me mbrojtësen e tij e caktuar sipas detyrës zyrtare Av. Latife Neziri, të akuzuarit F.Sh., me mbrojtësin të tij me autorizim Av. Burhan Qosa, i dëmtuari L.Sh., me përfaqësuesin e tij Av. Avni Ibrahimimi, me datë 24.11.2023 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 05.02.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1. I akuzuari **T.L.**, me vendbanimi në Ferizaj, në Lagjen “ ... “, i lindur më datë ..., në Fshatin ..., Komuna Ferizaj, nga i ati R., nëna Z., e gjinisë A., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion tregtar me numër personal ..., gjendet burgim i gjykuar për veprën penale vrasje.

2. I akuzuari F.Sh., me vendbanimi në fsh. .. rruga'''' nr..., i lindur më datë ..., nga i ati H., nëna Gj., e gjinisë H., shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer fakultetin juridik, punon në zyrën e noterit S.Sh., i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike nr. personal ..., mbrohet në liri.

I. I akuzuar T.L.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

- Më datë 17.08.2019 në Ferizaj rruga '' ...'', me anë të paraqitjes së rreme të fakteve dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, e mashtron të dëmtuarin L.Sh., dhe me këtë e nxitë të njëjtin që të kryej një veprim i cili rezulton në dëm material të pasurisë së tij, në atë mënyrë duke u paraqitur se kinse është pronar i banesës ... në katin e pestë të objektit tre (3), me sipërfaqe S= 125.24 m², për vlerë 53.000.00 Euro, e cila ka qenë në ndërtim e sipër në objektin banesor afarist '' G.R. 2'', sipas lejes ndërtimore 04-..../18 të lejuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit në Ferizaj, ashtu që së bashku me të pandehurin F.Sh., i cili e paraqet vetën si noter në zyrën e noteri S.Sh., ku dhe fillimisht përpilojnë një ''kontrata për shitjen e banesës në procesin ndërtimor'' duke fshehur kështu faktet dhe duke futur të dhëna të pasakta se në katin e pestë (5) gjendet banesa ..., me sipërfaqen S-125.24 m², e që në realitet në katin e pestë (5) banesës gjendet banesa ..., ndërsa në katin e tetë (8) gjendet banesa ..., ashtu pasi që lidhin kontratë me të dëmtuarin si blerës në njërën anë dhe si shitës i pandehuri T.L., në anën tjetër, duke u pajtuar me çmimin e përgjithshëm pesëdhjetë e tremijë (53.000.00) Euro, e cila shumë do kompensohet me veturën ''Audi A6'', me targa të regjistrimit WN ... e cila veturë ka vlerë prej njëzetë e shtatë mijë (27.000.00) Euro, e të cilën pas përpilimit të kontratës e merre në posedim i njëjti kurse pas një jave pas përpilimit të kontratës i dorëzohen në dorë e shuma prej dhjetëmijë (10.000.00) Euro, ndërsa sa i përket shumës prej shtatëmbëdhjetë mijë (17,000.00) Euro, kjo shumë e pagesës mbetet t'i paguhet pas përfundimit të objektit, duke i shkaktuar kështu të dëmtuarit dëme material në vlerë prej tridhjetë e shtatë mijë (37,000.00) Euro,-

- me këtë ka kryer veprën penale Mashtrim nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71, 72, 323 par.1 të KPRK-së, (Kodi nr. 04/L-082) dhe neneve 358, 359, 360, 361, 364, 365, 366, 449, 460 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032) e:

G J Y K O N

I. Të akuzuarit T.L., Për veprën penale Mashttrim, nga neni 323 par.1 të KPRK-së, të përshkruar si në dispozitiv të aktgjyqimit në pikën e I- rë, e dënon me Dënim me burg prej një (1) viti, dhe Dënim me gjobë në shumë prej 500 Euro (pesëqind euro), dënimet e shqiptuara me burg dhe me gjobë do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

- Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

- Konform nenit 59 par. 2 nën par. 2.2 lidhur me nenin 61, të KPRK-së, të akuzuarin T.L., i shqiptohet DËNIMI PLOTESUES – URDHRI PËR KOMPENSIMIN E DËMIT APO HUMBUES, ashtu që i akuzuari T.L. obligohet që të dëmtuarit L.Sh., t’ia paguaj demin e shkaktuar në vlerë prej 10,000 (dhjetëmijë) euro, në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi ta merr formën e prerë.

- Ndërsa i dëmtuarit L.Sh., nga fshati ... Komuan Ferizaj (me vendqëndrim në Gjermani) për pjesën tjetër të dëmit që i ka shkaktuar lidhur me veturën "Audi A6", udhëzohet në kontest civil.

- I akuzuari obligohet që gjykatës ti paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 50 Euro (pesëdhjetë euro), dhe shumën prej 20 (njëzet) euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim ta merr formën e prerë.

II. I akuzari F.Sh.

Ë S H T Ë F A J T O R

SEPSE:

- Më datë 17.08.2019 në Ferizaj, Rruga e "...", në zyrën e noterit S.Sh., me anë të paraqitjes së rreme të fakteve dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, e mashtron të dëmtuarin L.Sh., dhe me këtë e nxit të kryej një veprim i cili rezulton në dëm material të pasurisë së tij, në atë mënyrë pas marrëveshjes me të pandehurin T.L., dhe në prezencën e tij, duke u paraqitur si noter në zyrën e noterit S.Sh., e përpilon një "kontrata për shitjen e banesës në procesin ndërtimor", për banesën ... në katin e pestë të objektit tre (3), me sipërfaqe 125.24 m² për vlerë pesëdhjetë e tremij (53.000.00 Euro, e cila ka qenë në ndërtim e sipër në objektin banesor afarist "G.R. 2" në Ferizaj, e të cilën kontratë e nënshkruajnë i dëmtuari

si blerës në një të anë dhe i pandehur T.L. si shitës në anën tjetër e i cili për përpilimin e kësaj kontratës i paguan të pandehurit shumën prej 50 Euro,-

- me këtë ka kryer veprën penale Mashtrim nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 38, 39, 40, 43,46, 47, 48, 69, 70, 71, 72, 323 par.1 të KPRK-së, (Kodi nr. 04/L-082) dhe neneve 358, 359, 360, 361, 364, 365, 366, 449, 460 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032) e:

G J Y K O N

II. Të akuzuarit F.SH., Për veprën penale Mashtrim, nga neni 323 par.1 të KPRK-së, të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit në pikën e II- të, e dënon:

- Me dënim me burg me kusht prej 3 (tre) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen veprën tjetër penale në periudhën prej 1 (një) viti pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe

- Me dënim me gjobë shumë prej 200 / dyqind / Euro, të cilin dënim me gjobë i akuzuari obligohet ta paguaj, në afat prej 15 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-së, dënimi me gjobë do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga 20 Euro (njëzet) euro të gjobës.

- Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 35 Euro (tridhjetë e pesë euro,) ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 Euro,(njëzet euro) e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

- I dëmtuari L.Sh., me vendbanim në Fshatin ... komuna Ferizaj, me vendqëndrim në Gjermani lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

A r s y e t i m

Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm me datë 29.12.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1010/20, kundër të akuzuarave T.L., me vendbanim në

Ferizaj Lagjia ..., i akuzuar për veprën penale Mashtrim nga neni 323 pika 1 të KPRK-së dhe të akuzuarit F.Sh., me vendbanim në fshatin ... rruga “ ... ” nr...., i akuzuar për veprën penale Mashtrim nga neni 323 pika 1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 27.04.2021, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën ishin të ftuar dhe prezent prokurori i shtetit, Ardian Emini, përfaqësuesi i të dëmtuarit L.Sh. Av.Avni Ibrahimi, i akuzuari T.L., i akuzuari F.Sh. dhe mbrojtësi i tij me autorizim Av. Burhan Qosa, në të cilën seancë të akuzuarve pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohen por nuk e pranojnë fajësinë për kryerjen e tyre, me ç ‘rast gjykata në kuptim të nenit 245 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1,6.2 dh 6.3 të KPPRK-së i ka njoftuar të akuzuarit dhe mbrojtësin e të akuzuarit F.Sh., se mund të paraqesin kundërshtimet për provat e cekura në aktakuzë si dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës në afatin prej 30 ditësh.

Me datë 28.05.2021, mbrojtësi i të akuzuarit F.Sh., avokati Burhan Qosa, në Gjykatë ka dorëzuar kundërshtimin për provat e cekura në aktakuzë me kërkesën për hedhjen e aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj me arsyetimin se provat, veprat penale që janë përfshirë në parashkrim të dispozitivit të aktakuzës dhe se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari F.Sh., e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Komfor nenit 250 paragrafi 2 të KPPRK-së, gjykata i ka dhënë mundësinë prokurorit të shtetit që të përgjigjet në lidhje me kundërshtimet e mbrojtësit të akuzuarit mirëpo prokuroria nuk kishte dhen përgjigje në kundërshtim andaj me rastin e vendosjes lidhur me kundërshtimet e paraqitura nga ana e mbrojtjes kjo gjykatë me aktvendimin P.nr.1097/2020, të datës 04.06.2021, kishte refuzuar si të pabazuar kundërshtimet dhe kërkesën e paraqitur nga ana e mbrojtjes me arsyetimin se në këtë çështje penalo juridike ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar se i akuzuari F.Sh., ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, ku do ti ofrohet mundësia për shqyrtim të gjithanshëm gjyqësor, në këtë çështje penale, përmes të cilit do ti epet mundësia e shqyrtimit të provave të propozuara nga ana e prokurorit të shtetit duke mos i dhen vlerë të përcaktuar asnjë prove dhe pa predikuar epilogun përfundimtar të këtij gjykimi.

Kundër këtij Aktvendimi mbrojtësi i të pandehurit F.Sh., av. Buran Qosa, me datën 10.06.2021 në Gjykatë, në afatin ligjor ka dorëzuar Ankesë për Gjykatën e Apelit të Kosovës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPRK-së si dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, ndërsa Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin PN.nr.639/2021, të datës 03.08.2021, e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, avokatit Buah Qosa.

Gjykata me datën 30.12.2021, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin kryesor, ku prokurori i shtetit edhe në shqyrtimin kryesor të akuzuarve i ka lexuar aktakuzën për veprat penale që akuzohen, pas leximit të aktakuzës të akuzuarit veç e veç kanë deklaruar se e kanë të kjashtë i'u ka ofruar mundësinë që të konsultohet edhe me mbrojtësit e tyre dhe pas konsultimeve janë deklaruar të pafajshëm për veprat penale që akuzohen.

Pasi që të akuzuarit nuk e kanë pruar fajsinë për veprat penale që akuzohen, në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ka kërkuar nga prokurori i shtetit, përfaqësuesi i të dëmtuarit, i dëmtuari, mbrojtësit e të akuzuarve të përmbledhin provat që mbështesin rastin apo kërkesat e tyre në fjalën hyrëse ku edhe e kanë dhënë dhe janë njoftuar se për veprat penale që akuzohen të akuzuarit do të bëhet paraqitja e provave që përfshinë të gjitha faktet që gjykata i ka konsideruar të rëndësishëm për një gjykim të saktë dhe të drejtë, administrimi i provave personale dhe materiale si dhe pas administrimit të provave personale dhe materiale palët kanë dhënë fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurori i shtetit Avdullah Abedini, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë shqyrtimeve gjyqësore në këtë çështje penale janë administruar provat materiale dhe personale ku në cilësinë e të dëmtuarit është dëgjuar L.Sh., i cili ka deklaruar se në vitin 2019, ka blerë një banesë nga i pandehuri T.L., me çmim të përgjithshëm prej 53.000 (pesëdhjetë e tre mijë) Euro, banesa ... në katin V, me sipërfaqe prej 125,54 m², në ndërtime sipër në objektin banesor G.R. 2 në Ferizaj, ku për kompensim i dëmtuari i ka dhënë të pandehurit T.L., veturën Audi A6, në vlerë prej 27.000 Euro, e të cilën e merr në posedim i pandehuri e pastaj edhe shumën prej 10.000 (dhjetë mijë) Euro, ndërsa shumën prej 17.000 (shtatëmbëdhjetë mijë) Euro, kishte mbetur ta bëjë pagesën pas përfundimit të objektit, për të cilën banesë kishin lidhur edhe një kontratë tek zyra e noterit S.Sh., nga i pandehuri F.Sh.. I dëmtuari pas një kohe kishte shkuar me bashkëshorten e tij tek objekti banesor i lartë cekur dhe aty kishte takuar pronarin e objektit banesor F.R., dhe nga i njëjti ishte njoftuar se në këtë kat banesor dhe këtë sipërfaqe nuk kishte një banesë e tillë. Fakti se të dëmtuarin e kishte mashtruar i pandehuri T.L., ku është vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarit F.R., pronar i kompleksit banesor G.R., i cili dëshminë e tij në shqyrtimin gjyqësorë në këtë Gjykatë ka deklaruar se banesa me sipërfaqe prej 125,24 m², gjendet në katin e 8, ..., ndërsa banesa ... gjendet në katin e 5, pra që vërtetohet një fakt i rëndësishëm se i pandehuri e ka mashtruar të dëmtuarin me rastin shitjes së banesës. Gjatë shqyrtimeve gjyqësore në cilësinë e dëshmitarëve janë dëgjuar F.R.1., S.Sh., F.S., E.S. dhe dëshmitarët e tjerë të propozuar me aktakuzën me numër PP.II.nr.1010/20 të datës 29.12.2020. Po ashtu gjatë shqyrtimeve gjyqësore janë administruar edhe provat materiale të propozuara në

këtë aktakuzë siç janë: fotokopja e kontratës për shitblerjen e banesës në procesin ndërtimor dt.17.08.2019, fotokopja e librezës së qarkullimit të automjetit "Audi A6", plani i banesës ..., fotokopja e policës së sigurimit të mjetit nr....8 dt.17.09.2019, kartela e sigurimeve valid deri më dt.17.09.2020, karta ndërkombëtare e sigurimeve valid, marrëveshja për shitblerjen të dt.26.08.2019, mesazhet-komunikuese të dt.26.08.2019, dy fotokopje nga katalogu mbi shënimet për banesat e tjetërsuara për objektin ... të dt.25.02.2020, kontrata për shitblerjen e paligjshmërisë banesës në procesin ndërtimor LRP.nr.1.../2019 Ref.nr....7/2019 dt.24.07.2019, kontrata e punës e F.Sh., Vendimi për regjistrim në OAK-ës, të dhënat në lidhje me të kaluarën kriminale për të pandehurin T.L., foto dokumentacioni si dhe në shkresat tjera përcjellëse të lëndës. I pandehuri T.L., në shqyrtimin gjyqësorë të datës 02.11.2023, ka deklaruar se në vitin 2019 i ka shitur banesën të dëmtuarit L.Sh., në sipërfaqe prej 125,54 m², në çmim prej 53.000 Euro dhe si kompensim ka marrë veturën Audi A6, në vlerë prej 27.000 Euro dhe pas një jave ka pranuar edhe shumë prej 10.000 Euro, ndërsa shumë e mbetur prej 17.000 Euro, janë marrë vesh që i dëmtuari L.Sh., ta paguajë pas pranimit respektivisht hyrjes në banesë nga i dëmtuari, po ashtu ka deklaruar se ka lidhur kontratë me shkrim me të dëmtuarin, por deri më tani nuk është kompensuar në tërësi i dëmtuari nga i pandehuri. I pandehuri F.Sh., në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësorë me datën 02.11.2023, ka deklaruar se ka punuar tek noteri S.Sh., gjatë viteve 2015-2018, ku Gjykata nuk duhet ta marr si të bazuar këtë fakt për arsye se i dëmtuari ka deklaruar se kontratën e ka lidhur me noterin dhe aty ka përmendur edhe emrin e të pandehurit F.Sh., dhe pasi që kishte kuptuar se ishte mashtruar nga i pandehuri T.L., lidhur me banesën në fjalë ka shkuar direkt në Zyrën e Noterit ku kishte lidhur kontratën me qëllim që ta njoftojë përpiluesin e kësaj kontrate respektivisht të pandehurin F.Sh., se nuk ka pas të bëjë fare banesa e blerë që është përpiluar sipas kontratës. Po ashtu edhe një fakt të rëndësishëm edhe vet i pandehuri F.Sh., ka cek në shqyrtimin gjyqësor ka shkuar në shtëpinë e të dëmtuarit për tu sqaruar me të për kontratën të cilën e kishte përpiluar. Pas vlerësimit të gjithanshëm dhe të drejtë të provave personale dhe materiale mbetemi në tërësi pranë aktakuzës dhe konsideroj se ka prova të mjaftueshëm me të cilat u vërtetua se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar, andaj i propozojmë Gjykatës që të pandehurit ti shpall fajtorë dhe të ju shqiptoj një dënim me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili dënim do të jetë në proporcion me peshën e veprave penale, po ashtu Gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në bazë të nenit 69 të KPRK-së, si rrethana rënduese të merr shkallën e përgjegjësisë penale si dhe motivin për kryerjen e veprave penale.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit L.Sh., Av. Avni Ibrahimimi, në fjalën përfundimtare deklaroi se e përkrahi në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, i propozoj Gjykatës që me rastin e shqyrtimit të kësaj çështje penale të vendosë përkitazi edhe për kërkesën pasurore juridike, duke qenë se nuk është kontestuese fakti se i dëmtuari L.Sh., të pandehurit T.L., me datën 17.08.2019, i ka dorëzua në posedim dhe në pronësi automjetin e markës Audi A6, të prodhimit 2015, dhe pas një jave përkatësisht me datë 24.08.2019, i ka dorëzuar edhe shumën e të hollave prej 10.000 Euro, përmes ndërmjetësuesit nipit të tij i cili i ka dorëzuar të pandehurit T.L., shumën e cekur të cilën fakt as T.L., nuk e ka kontestuar gjatë zhvillimit të procedurës. Me këtë rast e njoftoj Gjykatën se pikërisht me datë 24.08.2022, të dëmtuarit L.Sh., është kthyer vetura e njëjtë, dhe përkitazi me vlerën e precizuar me propozimin në fjalën hyrëse se është dëmtuar i dëmtuari për shumën prej 27.000 Euro, plotësoj se tani nuk ekziston ky fakt por vetura e cila i është kthyer pas tri viteve të dëmtuarit, ka qenë në gjendje të dëmtuar dhe të amortizuar për të cilën të dëmtuarit i është dashur në serviset e autorizuara të i mënjanojë dëmtimet dhe amortizimet për të cilat shuma posedojnë fatura por meqenëse nuk kemi ekspertizë përkatëse i propozoj Gjykatës që për këtë pjesë të dënimit të cilin e ka pësuar i dëmtuari çështja të i referohet kontestit civil.

Mbrojtësja e të pandehurit T.L., e caktuar sipas detyrës zyrtare Av. Latife Neziri, e dorëzon me shkrim fjalën përfundimtare dhe në vazhdim e elaboron edhe me gojë ku deklaroi se në bazë të nenit 353 të KPPK-së, sipas detyrës zyrtare paraqes fjalën përfundimtare në emër të akuzuarit T.L., në çështjen penale P.nr.1097/20. Prokuroria Themelore Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP.II.1010/20, të datës 29.12.2020, ka akuzuar të mbrojturin tim për veprën penale Mashtrimi nga neni 323 par. 1 të KPRK-së, në të cilën pretendohet se me datë 17.08.2019, me paraqitjen fakteve të rreme dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të përfitimit pasuror për vete e mashtron të dëmtuarin L.Sh., ashtu që duke u paraqitur si pronar i banesës ... në katin e ..., te objekti ..., me sipërfaqe prej 125,54 m², e kontraktin shitblerjen për vlerën prej 53.000 Euro. Nga provat e administruara në këtë çështje penale edhe provat materiale dhe fizike është vërtetuar se i mbrojturi im nuk e ka kryer veprën penale për të cilën pretendon prokuroria dhe se kjo lëndë i përket çështjeve të natyrës kontraktore ku palët me vullnetin e tyre të lirë kanë hyrë në marrëdhënie kontraktore për shitblerjen e banesës, kjo marrëveshje është bërë me pëlqimin palëve ashtu që pala e dëmtuar ka qenë në njohuri të faktit se i mbrojturi im nuk ka qenë pronar juridik i banesës dhe mbi këtë bazë ata e kanë përpiluar një kontratë jo formale në të cilën kontratë në titull identifikohet se kjo është kontratë e shitblerjes së banesës në procedim ndërtimor. I dëmtuari ka qenë në njohuri se kjo banesë nuk ka qenë e gatshme dhe që pala tjetër kontraktuese shitësi nuk është pronar juridik se i mbrojturi im ka pas të drejtë ta shes këtë banesë

në procesin ndërtimor është dëshmuar në deklarinimin e tij në të cilin konstatohet se i mbrojturi im kishte paguar vlerën prej 87% të banesës për investitorin që në këtë rast është F.R.1., të dhënat të cilat do të mund të ishin vërtetuar po që se në këtë çështje penale do të kishin pasur mundësi që të shpalojmë provën e komunikimeve telefonike, fotove, shkëmbimeve të mesazheve të cilat kanë qenë në telefonin e të mbrojturit tim i cili telefon është sekuestruar me datë 12.12.2019, nga i mbrojturi im për një vepër tjetër penale. Prova e munguar e telefonit eventualisht mund të jetë kompromentuar dhe për këtë arsye ne besojmë se të dhënat që gjenden në telefon të marra nga raporti i ekspertizës rezultojnë të dhënat e komunikimeve telefonike deri me datë 28.05.2018, ndërsa mungojnë komunikimet telefonike prej asaj date e deri më datë 12.12.2019, kur është sekuestruar telefoni të mbrojturit tim. Prova të ngjashme të kërkuara me qëllim të dëshmimit edhe për këtë seancë janë administruar në procesin gjyqësorë me numër të lëndës 2020:077294, Aktgjykimi i datës 09.11.2020, i Gjykatës Themelore në Ferizaj Departamenti për Krime të Rënda ku në pjesën e pranimit të fajësisë citoj “fotografitë e SMS-ve të nxjerra nga telefoni i të pandehurit”, ky fakt dëshmojnë se pretendimet e të mbrojturit tim janë reale, meqenëse i njëjti është duke e vuajtur dënimin me aktgjykim të formës së prerë, andaj në secilin rast kur gabimet dhe dëmet procedurale që eventualisht mund të jenë kryer nga institucioni që e ka pas në mbikëqyrje këtë provë dhe i pamundësohet palëve që përmes atyre provave që të konfrontojnë dëshmitë kundërshtarë çështja do të duhet të interpretohet në favor të pandehurit. I mbrojturi im pretendon ashtu si në mbrojtjen e dhënë me datën 02.11.2023, meqenëse në trekëndëshin i dëmtuar, i pandehur dhe dëshmitar ka pas detyrime të pa përmbushura është krijuar narrativi lidhur me mashtrimin në këtë çështje penale. Sa i përket kërkesës pasurore juridike lidhur me veturën Audi A6, e kundërshtojmë në tërësi pasi që kjo veturë tani është gjetur. Vepra penale e Mashtrimit qëndron në paraqitjen e rreme të fakteve në fshehjen e fakteve apo në çfarëdo mënyre tjetër të mashtrimit të tri këto elemente subjektive nuk manifestohen me rastin tonë sepse i dëmtuari e ka ditur dhe e ka parë në mënyrë fizike objektin në ndërtim dhe e ka nënshkrua kontratën të cilën e ka ditë që është kontratë jo formale pasi që në kontratë janë përcaktuar në mënyrë të saktë të drejtat dhe detyrimet dhe udhëzimet e mëtejshme për bartjen e pronësisë gjithashtu përfitimi i kundërligjshëm pasuror nuk përmbushet sepse marrëdhënia në mes të dëmtuarit dhe të mbrojturit tim është marrëdhënie e pastër kontraktore nga e cila lindin detyrime dhe të drejta të dy asnjshme, andaj i propozojmë Gjykatës që pasi që të i ketë analizuar provat dhe dëshmitë të vendosë në bazë të gjendjes faktike posaçërisht dështimin për të siguruar provën direkte nga telefoni i të mbrojturit tim si pasojë e eventualisht dështimit institucional, meqenëse se gjendje faktike nuk konsumohet në normën juridike sipas propozimit të prokurorisë, nuk është arritur të provohet përtej dyshimit të bazuar se në këtë marrëdhënie kontraktore të ketë elemente

inkriminuese i propozojmë gjykatës që të nxjerr një aktgjykim lirues ndaj të mbrojturit tim dhe sipas nenit 363 par. 1 nën par. 1.1 vepra me të cilën i akuzuari akuzohet nuk përbën vepër penale është kontest që duhet të zgjidhej sipas ligjit të marrëdhënieve detyrimore dhe nën par. 1.3 se nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet sepse në këtë rast nuk ka fare vepër penale.

I pandehuri T.L., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem me fjalën përfundimtare të të mbrojturës sime, po ashtu shtoj se nga fillim i gjithë këtij procesi kur jam njoftuar me aktakuzën kërkesa ime e parë ka qenë sigurimi i provave në telefonin tim që tani është i sekuestruar me qëllimin të zbardhjes së vërtetë të rastit dhe kam kërkuar nga Gjykata që secili dëshmitar që merret në pyetje të më jepet mundësia që pyetjet e mia të i parashtrojë me fakte që gjenden në telefonin tim, tani të sekuestruar, dhe i kamë propozuar gjykatës që të sigurohet telefoni dhe në fund gjykata ka aprovuar kërkesën time për nxjerrjen e provave të telefonit, por nga nxjerrja e atyre provave dhe nga ekspertiza e telefonit rezulton që gjithçka që gjendet brenda telefonit është deri në vitin 2018, vit që nuk përkon me lidhjen e marrëveshjes ose me rastin që tani akuzohem dhe mos deklarimi i këtyre provave ose shkatërrimi i qëllimshëm i këtyre provave nga cili çdo institucion, ka vetëm një qëllim dëmtimin e tyre me qëllim dënimit tim sepse që kur është ngritur aktakuza ndaj meje unë nuk kam qenë person ilirë por kam qenë person i privuar nga liria prej datës 12.12.2019, dhe pas kësaj date nga personat e pretenduar si i dëmtuar dhe nga personat e tjerë që unë nuk kam dashur përmes provave faktike në telefonin tim të i paraqes para Gjykatës është shfrytëzuar mungesa ime dhe privimi im nga liria për përfitimet e tyre materiale dhe sot i gjithë ky proces ka mundur të ketë kahja tjetër po që të ishte telefoni por personat që kanë shkatërruar provat në atë telefon i kanë kontribuar aktakuzës së prokurorisë që sot unë të akuzohem për mashtrim. Unë kam deklaruar se nuk e ndiej veten fajtorë sepse në këtë rast nuk ka aspak mashtrim apo detyrim apo sidoqoftë por gjithçka ka ndodhur me vullnetin e lirë me mirëbesim dhe me marrëveshje paraprake, kërkojë nga Gjykata që të i ketë parasysh të gjithë çfarë thash unë dhe e mbrojtura ime dhe gjithë fjalën time që e kam dhënë në mbrojtjen time që e kam dhënë në seancën e kaluar, kam deklaruar edhe për personin tani të akuzuar në këtë vepër me mua sepse pikë së pari as lidhja ime para kontratës me personin e pretenduar si i dëmtuar nuk ka mashtrim dhe po ashtu, lidhja e kontratës që i pretenduari i dëmtuar pretendon se është lidhur “ te noteri ”, ajo nuk qëndron por ka si qëllim dëmtimin e imazhit ose dëmtim pasuror dhe në këtë rast i kërkojë Gjykatës që gjithë ky rast i kësaj seance dhe seancat e kaluara për hir të drejtësisë të merr vendimin e merituar sepse një dënim ndaj meje ose ndaj personit të akuzuar bashkë me mua

me bindjen e plotë nuk do të ishte drejtësi e qëlluar, por do të ishte një nënçmim për mua që jam i privuar nga liria.

Mbrojtësi i të pandehurit F.Sh., av. Burhan Qosa, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesim fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim, kundërshtojmë në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit e cila përveç se ka një interpretim i deklarimeve të palëve të dëmtuara në asnjë rast prokurori nuk ka arritur që ato deklarime të i përdorë për të i vërtetuar Gjykatës se në këtë çështje penale të jenë vërtetuar dispozitivat e aktakuzës, konsideroj se sikur prokurori i çështjes që ka ngritur aktakuzën ashtu edhe prokurori i rastit në fjalën përfundimtare edhe prokurorët që e kanë trajtuar këtë çështje penale që të gjithë kanë vepruar në kundërshtim me nenin 47 të KPPK-së, duke e bërë këtë procedim gjyqësor në kundërshtim me Kushtetutën e Republikë së Kosovës, respektivisht dispozitave kushtetuese të cilat të pandehurve në Republikën e Kosovës, i sigurojnë mbrojtje edhe nga organi akuzës në interpretim të nenit 47 të KPP-së për të grumbulluar prova shfajësuese. Prokuroria e shtetit ka dështuar në të gjitha proceset që deklaratën e të dëmtuarit dhe bashkëshortes së tij ta krahasojë me deklaratën e nipit të tyre D.A., i cili si në prokurori ashtu edhe në gjykatë ka deklaruar se ai ishte në fillim në dijeni në lidhje me rastin do të jepte deklaratë në prokurori e datës 10.12.2020, dhe ka deklaruar se data nuk i kujtohet saktë por ka qenë ai së bashku me dajën e tij L.Sh., si dhe gjashtë persona të tjerë familjar në lokalet e H.P. në Ferizaj, para Institucionit të Prokurorisë, ku përveç gjashtë personave kanë qenë edhe shokët e T.L.t, edhe L.Sh.. Në Gjykatë me rastin e dhënies së deklaratës ka vërtetuar faktin se kanë qenë dhjetë persona dhe këtë fakt e ka pohuar edhe i dëmtuari L.Sh., me deklaratën e tij në Gjykatë e po ashtu është vërtetuar se ai takim ka ndodhur para përpilimit të kontratës ku dëshmitari D.A., ka treguar në deklarinimin e tij si në Prokurori dhe Gjykatë se po atë ditë që i bie në prezencën e dhjetë personave është bërë shitblerja e banesës. Po ashtu i njëjti ka deklaruar se po atë ditë T.L., ka dalë me dajën e tij L. dhe e kanë shikuar veturën, “Audi A6 “ të cilën T.L., e ka marrë si kompensim për shitblerjen e asaj banese. Më e çuditshmja në këtë shqyrtim ka ndodh se është pikërisht T.L., i cili me deklarinimin e tij të dhënë në seancën e kaluar e ka rrëfyer në mënyrë korrekte situatën sikur dëshmitari D.A., i cili është nip i palës së dëmtuar L.Sh., që nënkupton se deklarata e T.L., është absolutisht korrekte edhe dhënë para gjyqtarit të çështjes dhe si e tillë konsideroj se Gjykata duhet ta trajtojë, e jo ta trajtojë fjalën përfundimtare të prokurorit të çështjes i cili lëshohet vetëm në deklarinimet e palës së dëmtuar e i cili kishte guximin se para kësaj Gjykate të deklarohej se nuk ishte në dijeni se në takimin në H.P. të kishte qenë prezent nipi i tij D.A.. Me procesverbalin kur është dëgjuar L.Sh., në Gjykatë e keni dhe mundë ta vërtetoni deklarinimin tim, të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me D.A., i dëmtuari i ka devijuar duke u shitur kinse si kujtohen ndërsa profesionin

e tij në deklarin në polici e ka deklaruar se është udhëheqës i punëtorëve që i bie se i njëjti sëpaku klasën e tetë të shkollës fillore e ka të kryer. Për të vërtetuar se dëshmia e dëshmitarit L.Sh. dhe bashkëshortes së tij kanë qenë absolutisht gënjeshtër para Gjykatës, Gjykata mund të i referohet vetëm deklaratës së nipit të tyre, bashkëshortja e dëshmitarit L.Sh., meqë ishte përgatitur për ta ngarkuar përfundimisht klientin tim kinse kontratën e kishin lidhur te Zyrja e Noterit S.Sh., para kësaj Gjykate kishte guximin të deklaronte kinse kur ata kanë shkuar për ta lidhur kontratën me T.L., klienti im ua kishte prezantuar planin e banesës. Edhe njëherë ftoj Gjykatën që ta lexojë me kujdes deklaratën e dëshmitarit nipit të palës së dëmtuar D.A., i cili me datë 10.12.2020, në prokurori ka deklaruar cituar si në deklaratë “ Te H.P. nën prezencën tonë” (që i bie nën prezencën e nënë (9) personave të tjerë plus T.L.). L.Sh., është njoftuar nga T.L. me planet e banesës, që do të thotë se deklarata e dëshmitares bashkëshortes së të dëmtuarit ka qenë tendencë vetëm e vetëm për ta inkriminuar klientin tim pa asnjë bazë, por nga frika e tyre se duke ditur se T.L. ishte në vuajtje të dënimit ata shihen qartë se pretendojnë të kompensohen nga klienti im apo edhe për të provuar që në një formë të arrijnë ta bëjnë më të besueshme aktakuzën ndaj T.L.. Meqë unë pajtohem plotësisht me mbrojtjen e T.L. mbrojtësen e tij avokaten kur thotë se në këtë çështje penale përveç asaj se mund të ketë kontest civil nuk mund të ketë tjetër e aq më pak vepër penale. Unë nuk e kuptoj faktin se prokuroria nuk e ka analizuar provën materiale respektivisht vendimin e OAK-së, (Odës së Avokatëve të Kosovës), me të cilën provë klienti im ka dëshmuar se në kohën e lidhjes së kontratës ka qenë praktikant në zyrën e avokates E.Sh., po ashtu shtoj se është tepër e çuditshme që prokuroria edhe përkundër këtij fakti nuk e thërret për ta konsideruar nëse mund me nxjerr provë shfajësuese për të mbrojturin tim përmes dëshmitares E.Sh., nëse eventualisht prokuroria nuk e konsideron si të ligjshëm vendimin e OAK-së që dëshmon se klienti im ka qenë praktikant, e po ashtu prokuroria nuk i është drejtuar me asnjë shkresë OAK-së nëse ajo ka dyshime në lidhje me praktikantin, kjo tregon se në rastin konkret i gjithë procedimi i çështje që nga fillimi hetimit e deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor është bërë në kundërshtim me KPPK-së, pavarësisht në fjalën përfundimtare me prova të pa kontestueshme me citate e kam përshkruar vërtetimin se klienti im nuk mund të jetë përgjegjës apo kryes i veprës penale për të cilën e ka akuzuar prokuroria, në këtë çështje penale ajo çka më ka shqetësuar më shumti është fakti se avokatja mbrojtëse e të pandehurit T.L. kësaj Gjykate i ka sjellë një dëshmi çoftë në formë rrëfimi ku thotë se në Aktgjykimin e datës 10.12.2020, me numër të lëndës 2019:290167, në pjesën të vlerësimi i pranimit të fajësisë thuhet që T.L.t i është konfiskuar telefoni me datë 12.12.2019, dhe në shtjellimin e pranimit të fajësisë kjo Gjykatë thotë se aktakuza në atë çështje përputhet me provat që njëra nga to janë edhe fotografitë e SMS-ve të nxjerra nga telefoni i të pandehurit, ne të gjithë e dimë se i pandehuri T.L., për veprën për të cilën është dënuar mbi 20

vite, ku i'u kishte konfiskuar telefoni ishte arrestuar shumë shpejt, që i bie se me atë provë materiale përmes telefonit kjo Gjykatë ka vërtetuar edhe pranimin e fajësisë së tij duke e konsideruar se përputhet me fotografitë dhe sms-të, e që janë të vitit 2019, respektivisht mund të jenë viti 2019 i muajit dymbëdhjetë (12), ku janë provat pas datës 28.05.2018, që nuk figurojnë të nxjerra me ekspertizë në këtë çështje ku po dihet se me çështjen që ka rrjedhë aktgjykimi i datës 09.11.2020, kanë ekzistuar, kjo vërteton punën e prokurorisë e cila ekskluzivisht duke i selektuar provat vetëm në drejtim të deklaramit të dëmtuarit ka arritur me ngritë aktakuzë dhe po pretendon edhe me fjalë përfundimtare që për një kontratë të marrëdhënies të detyrimeve të i shpall dy persona të fajshëm me mundësinë që i është dhënë nga cili do rast dhe institucion. Meqë paraprakisht rezulton se janë dëmtuar provat përfundimtare e të cilat i ka kërkuar T.L., me kohë dhe arsye për ta përballur çdo dëshmitar në këtë çështje penale. Nga e gjithë kjo që u tha konsideroj se në mënyrë të pa kontestueshëm Gjykata ka prova të mjaftueshme për ta shpallur klientin tim të pa fajshëm në kuptim të nenit 363 par. 1 pika 1.3.KPPRK-së

I pandehuri F.Sh., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të të mbrojturit tim dhe nuk kam për të shtuar asgjë pasi që për veprën që akuzohem jam i pa fajshëm dhe i propozoj Gjykatës që të merr aktgjykim lirues.

Gjykata në këtë çështje penale ka bërë paraqitjen e provave që përfshin të gjitha faktet që gjykata i ka konsideruar të rëndësishme për një gjykim të drejt dhe të saktë bazua në nenin 325 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032).

Deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit L.Sh.

I dëmtuari L.Sh., në cilësinë e dëshmitarit në seancë e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 30.12.2021, dhe vazhduar me datën 18.05.2022, ka deklaruar se unë lidhur me këtë rast që mu është shkaktuar dëmi kam dhanë deklaratë në polici edhe në prokurori dhe i mbështes të gjitha deklaratat që i kam dhënë. Herën e parë lidhur me këtë çështje jam takuar me të pandehurin T.L., në muajin Gusht të vitit 2019, përball objektit të Postës në Qendër të qytetit në Ferizaj. Edhe pse më herët nuk e kam njohur, kemi filluar bisedën me te ku prezent ishin personat L.A. dhe N.N. dhe kemi biseduar me T.L., për një banesë që e kishte pasi që kisha interesim që ta blejë një banesë dhe më tha që e kam tek Objekti G.R., përballë Objektit të Gjykatës në Ferizaj dhe aty kanë filluar bisedimet lidhur me blerjen e banesës. Bisedë me T.L.n, kemi zhvillu edhe një dit më vonë tek Pompa e benzinës H.P., dhe unë i kam thënë se nëse arrimë marrëveshje për blerjen e banesës kërkoj që çdo marrëveshje që arrihet të bëhet tek zyra e noterit. Sa i përket takimit te H.P. nuk kemi arritur kurrfarë marrëveshje që të arrijmë tek kontrata për blerjen e banesës, por së bashku me bashkëshorten time dhe T.L.n,

kemi shkuar tek ndërtesa e G.R. ku ishte banesa në katin e ... për të cilën kemi biseduar, por banesa ende nuk ishte e përfunduar por ishte në ndërtim e sipër, por e kemi shikuar banesën dhe na pëlqej dhe siç më kujtohet ka qenë në sipërfaqe prej 124 ose 125 m². Unë T.L.n për këtë banesë e kam pyetur për dokumentacion a është në rregull dhe në emër të tij dhe më ka thënë që ende nuk është në emër të tij, por është investitor në këtë banesë, por T.L., më ka njoftua se tek noteri i posedojmë të gjitha të dhënat për këtë banesë dhe të gjitha këto i kemi diskutuar në prezencë të bashkëshortes sime K.Sh., por blerjen e kësaj banese e kemi lënë të takohemi tek noteri S.Sh., ku kam shkuar me bashkëshorten dhe T.L.n, por unë nuk e kam njoftua më parë noterin, por aty ishin disa punëtor por brenda zyrës së noterit gjatë dëshmisë time kam përgatit një skicë të dhomave që ishin aty siç e kam parë kur kam hyrë dhe aty ishte një dhomë që shkruante " Noteri ". Deklaroj se unë me bashkëshorten time K. dhe T.L.n, kemi arritur marrëveshje dhe është përpiluar kontrata, dhe në atë zyre që e ceka ishte personi që është prezent në cilësinë e të akuzuarit F.Sh., por ai nuk me ka treguar çfarë detyre ka dhe F., siç më kujtohet ka thënë se këtu është zyra e noterit, ku unë jam ndjerë i sigurt aty, ku unë kam veprua gjithçka siç më ka udhëzuar F.Sh., ku aty kam qëndruar diku dy orë. F.Sh., siç më kujtohet e ka nxjerrë nga kompjuteri tij kontratën dhe e kam lexuar dhe të njëjtën e kam nënshkruar dhe sipas mendimit tim ka qenë gjithë çka në rregull siç përshkruhet në kontratë. Në bazë të marrëveshjes së kësaj kontrate për blerjen e kësaj banese kemi arritur marrëveshjen e çmimit dhe atë në shumë prej 53.000 (pesëdhjetë e tremijë) Euro, mirëpo në marrëveshjen me T.L.n ka qenë këtë çmim të llogaritet Vetura ime Audi A6 në vlerë të llogaritur prej 27.000 Euro (njëzetë e shtatë mijë euro) dhe pjesën tjetër brenda një jave të epet një shumë prej 10.000, (dhjetë mijë) Euro dhe atë shumë ja kam dërguar përmes transferit të bankës dëshmitarit D.A., të cilin e kam nip, ku ai ja ka dërguar T.L.t, fizikisht dhe T.L. pastaj më ka dërguar një mesazh se i ka pranuar paratë, mirëpo në bazë të kontratës pos shumave të cekura, kam mbet ti paguaj një shumë prej 17.000 (shtatëmbëdhjetë mijë) Euro, e këtë shumë kam pas me i'a dorëzua kur të përfundohet banesa dhe të vendosem në te.

Unë më vonë pas dëgjimit në media për rastin tjetër që është zhvilluar për T.L.n, kam vendos të vijë në Kosovë, me bashkëshorten dhe kam dashtë të njoftohem lidhur me banesën, ku kam shkuar te objekti i banesës dhe aty kam takuar personin F.R. dhe i kam treguar se kam kontratë për këtë banesë dhe e kam pyetur se kujt t'ia dërgoj të hollat e mbetura pasi që T.L., është i burgosur. Siç më kujtohet unë nga F.R., jam informuar se kjo banesë nuk ekziston në bazë të dhënave, dhe të gjitha atyre që përshkruhen në këtë kontratë, ku F.R. pas leximit të kontratës më njoftoj se nuk janë të vërteta dhe me njoftoj se çdo kontratë për shitblerjen e banesave i bëjë te noteri S.Sh. por unë e njoftova F.R., se këtë

kontratë e kam bërë pikërisht te noteri S., por F.R., më tha se të gjitha këto të dhëna në kontratë janë të gjitha false dhe me tha se të paskan mashtruar. F.R., siç më kujtohet me ka thënë se këto përshkrime nuk janë të vërteta, por merre këtë kontratë dhe shko te S.Sh. dhe konsultohu.

Të nesërmen së bashku me bashkëshorten kemi shkuar në mëngjes ne ora 09:00 h tek noteri S.Sh., dhe kur kam shkuar e pashë një person tjetër prej asaj dite kur është përpiluar kontrata, pra nuk ishte F. por dikush tjetër, kishte punëtor tjerë aty por në zyre ishte vetëm ai, dhe unë i thash më duhet noteri ai personi tjetër që ma ka përpiluar kontratën me tha se nuk ka noter tjetër pos meje S.Sh., por unë i thash S., është person tjetër siç e njoh unë, por ai më tha jo S. jam unë noteri. Ai më tha unë jam noteri dhe ma kërkoi kontratën që i'a afrova dhe të njëjtën e ka lexuar dhe pas leximit të njëjtit i'u duk diçka e çuditëse, unë u ula në zyrën e tij por i njëjti pas leximit të kësaj kontrate është befasuar dhe në ndërkohë aty ka ardhur një grua ku mora vesh se është bashkëshortja e tij dhe i kanë mbyllur dyert e zyrës që ishim prezent me qelës, dhe i kam shpjeguar se si ka ardhur deri te përpilimi i kësaj kontrate, dhe i thashë se në këtë zyre kam qenë i ulur këtu bashkë me bashkëshorten, ka qenë edhe personi prezent F.Sh. dhe T.L. dhe më tha se nuk është e mundur që të bëjë nipi im këtë kontratë dhe të më bëjë këtë gjë dhe unë me bashkëshorten time pasi e vërtetuam se çdo gjë që është bërë nuk është e vërtetë. Të dëmtuarin

T dëmtuarin L.Sh., me lejen e gjykatës prokurorja e shtetit e ballafaqon me deklaratën e dhënë ne Stacionin Policor me datë 31.12.2019 ne faqen 2 në reshtin 17 " pasi që e shikoi kontratën ai më tha se kjo kontratë nuk është vlefshme dhe se kjo kontratë nuk është bërë tek unë, dhe unë i thash se në këtë zyre e kam bërë kontratën dhe më keni garantuar se gjithçka është në rregull, kurse ai më tha se kontrata nuk është valide, un ja tregova fotografinë e personit i cili ka përpiluar kontratën, kurse ai më tha se ky është vetëm një punëtorë që punon për mua", por pas leximit nga prokurorja e shtetit, deklaroj se kjo është e vërtetë kjo që kam thënë dhe as që më ka treguar se është nipi i tij.

Pas kësaj date jam takuar disa herë me noterin S.Sh. te H.P., në Ferizaj ku prezent ishte edhe bashkëshortja kemi biseduar për këtë rast dhe më ka thënë do të merremi vesh do të këtë zgjidhje kjo punë, më ka thënë po presim ta gjejmë veturën kurse për të hollat do t'ia bëjmë një zgjidhje, e përsëris se S. më ka thënë për veturën që e ke dhënë në lidhje me blerjen e banesës do marrim veprime që përmes policisë ta gjejmë dhe ta kthejmë, kurse për shumën prej 10.000 Euro (dhjetëmijë euro), më ka thënë se do ja bëjmë disi, i njëjti me ka thënë se T.L., ka lidhur disa kontrata mbi blerjen e banesave dhe janë në rregull. Qëllimi im

ka qenë që ta realizoj banesën dhe ta marr atë banesë që i kam dhënë parat për te, por asnjëherë deri më tani nuk është realizuar dhe me që nuk ka mund të realizohet e drejta ime që të sigurohet banesa e kam hap rastin në polici dhe nga atëherë deri më tani nuk është bërë zgjidhje e saj.

Në pyetjen e parashtruara nga përfaqësues i tij, av. Avni Ibrahim, i dëmtuari L.Sh., është përgjigjur, se në emër të çmimit që e kemi arrit me T.L.n, për blerjen e banesës, i cili çmim është shënuar në kontratë me shkrim me datën e cekur ku jemi marrë veshë që me dhënë veturën time ku i kam dhënë atë ditë që kam bërë marrëveshje, dhe pas nënshkrimit të marrëveshjes i kam dhen edhe parat në shumën e cekur më lartë. Qelsin e veturës e kam dorëzo tek zyra e noterit S.. Dokumentet e veturës nuk i kam dorëzuar pasi duhej te behej çlajmrimi në shtetin e Gjermanisë, kurse qelsin rezervë të dytë dhe dokumentet e veturës ja kam dërgua përmes një personi që ka udhëtuar për Ferizaj, prej Gjermanisë dhe T.L. ka dalë e i ka marr. Kontratën e blerjes së banesës e kam nënshkruar unë si blerës dhe shitës T.L., ku kemi pasur dokumentet tona personale pasaportën por edhe T.L. i ka pasur. Diku në dhjetor të vitit 2019 jam kthyer në Kosovë, pasi u njoftova nga mediat se ka ndodhur diçka me T.L.n, por nuk munda me takuar se nuk e disha se a është në liri dhe adresën e banimet se ku është tu jetuar.

Ne pyetjet e parashtruara nga mbrojtësi i të akuzuarit F.Sh., Av. Burhan Qosa, i dëmtuari ne cilësinë e dëshmitarit L.Sh., është përgjigjur se për këtë rast kam dhënë deklaratat dhe i mbështes ne tërësi deklaratat që kam dhënë, lidhur për atë që po më pyetni por e njoftoj gjyqtarin dhe prokurorin e shtetit se për këtë kam dhënë deklaratë edhe në shtetin ku jetoj në Gjermani, pasi që kam nënshtetasin Gjermane. Datat kur kam dhënë deklaratë nuk më kujtohen saktësisht, por qëndroj pranë çdo deklarate që kam dhënë pasi qe ato i kam dhënë pas udhëzimeve që më janë ofruar dhe i përmbahem deklaratave që kam dhënë, dhe fotografit e F.Sh.t dhe T.L.t, u kam ofruar Autoriteteve Gjermane, dhe sa i përket fotografive i kam marrë nga rrjeti social për të ditë se me ka jam duke biseduar lidhur me blerjen e banesës sepse nuk i kam njohur më herët, që të lidhi këtë kontratë kurse foto direkt nuk kam bërë. Unë jam nënshkruar i Kontratës për blerjen e banesës ku e kam nënshkruar këtë kontratë në bazë të urdhërave të noterit dhe aty ku më ka thënë nënshkruaj unë e kam nënshkruar.

Në Vazhdim mbrojtësi i të akuzuarit F.Sh., Av. Burhan Qosa, i parashtron pyetje: Ju sapo deklaruat qe kontratën e keni nënshkruar me urdhër te Noterit, atëherë ne faqen 6 te kësaj kontrate paragrafi nr. 2 , dhe atë të pjesa ku është potencuar Regjistrimi apo transferimi i titullit të pronësisë, dhe mundësia e ndryshimit te kontratës, dhe avokati i lexon këtë paragraf, pas leximit i

parashtron pyetje, a mund të i thoni gjykatës çka nënkuptoni ju kur e ngarkoni ju klientin tim, kinse ai të ka detyruar duke u thirrur si noter për ta nënshkruar kontratën që në paragraf shihet qarte që ju keni lidhe një kontrate dhe keni qene ne dijeni se po lidhni një kontrate nga një person jo i licencuar si Noter. Përgjigje : Nuk është e vërtet, por i njëjti me ka thënë ti je te noteri dhe për çdo gjë je i sigurt dhe s' do të kesh probleme në të ardhmen sa i përket kësaj kontrate, ku kam pas një besueshmëri që te noteri nuk do të më ndodhe diçka e keqe. Me lejen e gjykatës Avokati Burhan Qosa, i ofron të dëmtuarit që të shikon faqen 6 te kontratës se lartë cekur, dhe e ballafaqon se a është nënshkrimi i juaji apo jo ? Përgjigjja : Po nuk e mohoj , nënshkrimi është i imi. Me lejen e gjykatës të dëmtuarin e ballafaqoj me paragrafin e fundit të faqes nr. 2 te kontratës. Pyetje : Palët janë njoftuar dhe janë ne dijeni ... , pas leximit e pyet a e keni ditur që ekziston ky paragraf në këtë Kontratë ? Përgjigje: Nuk e kam ditur që ka dispozitë ligjore, dhe unë pagesat i bëjë vetëm përmes gjyrollogarisë bankare. Pyetje : A mundë të i thoni gjykatës shumën prej 10.000 (dhjetëmijë) Euro, që i keni paguar lidhur me kontratën e shitblerjes e të cilën e keni paraqit si dëme, a ja keni paguar shitësit te asaj banese T.L., përmes transaksionit Bankar ? Përgjigje : Jo përmes bankës sepse nuk ka funksionuar gjyrollogaria ne emër të T.L., atëherë u detyrova unë që kushëririt tim D.A., të i'a dërgoj paratë në të njëjtën ditë T.L., me dëshmitar i ka marr paratë, i kam edhe sms që me ka njoftuar që i ka marre parat. Pyetje : A mundesh ti thoni gjykatës kur je takuar për herë të parë me T.L. , dhe sa here jeni takuar me te , dhe a e keni pyetur a ka gjyrollogari bankare apo jo ? Përgjigje : siç kam potencuar më herët, herën e parë e kam takuar përball postës ndërsa herën e dytë te H.P. përball Stacionit Policor në Ferizaj, dhe herën e tretë kam shkuar tek noteri, dhe pas takimit tek noteri së bashku me T.L.n, kemi shkuar për të shikuar banesën, dhe pas shikimit të banesës jemi rikthyer prapë tek Noteri për te lidh kontratën. Pyetje : Ju sapo deklaruar që keni shkuar fillimisht tek noteri, keni shkuar tek banesa, dhe prapë jeni rikthyer tek noteri, a munde të i tregoni gjykatës në atë zyrën ku keni qenë ju a ka ndonjë Logo ? Përgjigje : Aty shkruante me të mëdhaja Zyra Noteriale, por diçka tjetër nuk kam vërejtur. Pyetje: Ju keni deklaruar që dy orë është vonuar gjatë përpilimit të kontratës F.Sh. a është e vërtetë ? Përgjigje: Po ashtu është, dy orë ka zgjatur gjatë përpilimit te kontratës. Pyetje : A munde të i thoni gjykatës a është e vërtetë që kur keni shkuar tek noteri, e ka nxjerr kontratën menjëherë d.m.th ka qenë e gatshme apo keni qëndruar dy orë siç keni deklaruar më herët, cila është e vërteta ? Përgjigje : Nuk e di saktë se sa ka zgjatë koha meqë ka kaluar një kohë e gjatë, derisa ka shkruar ai në kompjuter më ka bërë disa pyetje të ndryshme, dhe nuk e kam shikuar saktë se sa ka zgjat, por e mbështes çdo deklaratë unë që kamë dhënë. Pyetje : Meqë ne prokurori keni deklaruar që kontrata kishte qenë e kryer, a mundë të i thoni gjykatës, ju kur keni shkuar si jeni paraqitur aty, a keni dhënë ndonjë dokument identifikues ? Përgjigje: Po i kemi treguar dy pasaportat timin edhe të

bashkëshortes sepse ashtu ishin procedurat për të hartuar kontratën e shitblerjes. Pyetje: Ju keni deklaruar në polici se me vonë e keni takuar personin me emrin F.R.? Përgjigje : Po e kam takuar që të i'a dorëzoj të hollat, dhe nuk e kam ditë se kush është pronar i këtij kompleksi banesor, edhe pse shkruante në kontratë, por personalisht nuk e kam njohur, vetëm isha i orientuar se kujt duhet të i'a jepja edhe pjesën tjetër të shumës së parave që kisha obligim. Por si me tha që ju kanë mashtruar, dhe aty e kam vërejtur se çka ka ndodhur. Pyetje : A mundë të na shpjegoni për çfarë arsye e ke paraqit rastin në shtetin e Gjermani sa i përket veturës Audi A6 me targe te regjistrimit W ... dhe ku e keni paraqit ? Përgjigje : Në policin Gjermane, dhe të njëjtën deklaratë e kam dhënë edhe atje, i kam njoftuar për atë që i ka ndodhur pasi që kam nënshtetësi Gjermane. Pyetje: A keni kërkuar që të merren veprime për veturë ? Përgjigje : Po ashtu siç e kam deklaruar edhe këtu ashtu edhe në Gjermani. Pyetje : A keni informata se ku është sot vetura ? Përgjigje : Në Gjerman dy herë më kanë njoftuar sa i përket veturës, herën e parë është hasur në Preshevë dhe është konfiskuar vetura, me kanë njoftua se do ta sjellim veturën, por deri më tani nuk e kanë sjell. Pyetje : A e ke çlajmru veturën në Gjermani , dhe kujt ja ke dërgua atë librezë ? Përgjigje : po dhe librezën e çlajmërimit ja kam dorëzuar një pasagjeri të avionit që të i'a sjell T.L.t, dhe me ka njoftuar që ja ka dorëzuar, por edhe qelsin e dytë të veturës. Mbrojtësi i të pandehurit F.Sh. e njofton gjykatën se vetura është konfiskuar, ku për këtë gjykatës i ofron edhe dëshmi që të ti bashkëngjitet shkresave të kësaj lënde penale.

Deklarata e dëshmitares K.Sh.

Dëshmitarja K.Sh., në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 18.05.2022, ka deklaruar se është e vërtetë që unë me bashkëshortin tim L.Sh., kemi shkuar tek noteri në Ferizaj dhe atë tek Noteri S.Sh., për herë të parë personin që është prezent në cilësinë e të akuzuarit F.Sh., e kam parë tek zyra e noterit, dhe është e vërtetë se ne jemi takuar aty, dhe pas bisedës me të së bashku me të akuzuarin T.L. dhe bashkëshortin tim L.Sh., kemi shkuar për të shikuar Banesën e cila ishte në ndërtim e sipërm dhe qëllimi ynë ishte që ne ta blejmë atë banesë dhe pas shikimit të banesës jemi kthyer prapë për të lidhur marrëveshje tek Zyra e Noterit, ku kemi hyrë brenda në zyrën noteriale personi që është i akuzuar prezent në seancën gjyqësore që po zhvillohet tani në Gjykatë, F.Sh., është paraqitur si noter, jemi ulur së bashku me bashkëshortin aty, na ka përshkruar planin e banesës se si do të jetë, ne ishim shumë të kënaqur në bazë të planit që e shihnim, dhe na ka shpjeguar në detale dhe në mënyrë shumë të kjartë, sqarimet e tij kanë qenë perfektë, na ka parashtrua pyetje të ndryshme sa i përket se si dëshironi të duket banesa. Nuk kam besuar që do të ndodhte kjo që ndodhi nga asnjëri prej palëve as nga T.L., e as nga F.Sh.. E kemi bërë marrëveshjen sa i përket çmimit të banesës si dhe mënyrat se si do të bëhet pagesa e asaj banese.

Pas arritjes së marrëveshje për blerjen e banesës kemi pas me i'a ofrua veturën e tipit Audi, që ishte në pronësi të bashkëshortit, e cila veturë ishte vlerësuar me shumën prej 27.000 (njëzetë e shtatë mijë) Euro dhe kemi pas me i dhanë dhe 10.000 (dhjetë mijë) Euro kesh, dhe pas përfundimit të banesës kur të pranohen çelësat e hyrjes në banesë, kemi pas me i dhanë edhe 17,000 (shtatëmbëdhjetë mijë), Euro me kujtohet se kemi dorëzuar librezën, çelësat e veturës, i'a kemi dhe në T.L., në prezencën e F.Sh.t. Më pastaj kemi dëgjuar për një rast që ka ndodhur një tragjedi ku i akuzuari T.L., dhe në kemi ardhur në Kosovë që të njoftohemi se kujt t'ia dorëzojmë shumën tjetër të parave pasi që T.L., nuk gjendet në liri. Qëllimi i jonë ka qenë se kujt t'ia dorëzojmë parat dhe jo se na ka ndodhe diçka e keqe. Kemi shkuar në zyrën Noteriale ku kemi kërkuar noterin, por është lajmëruar S.Sh., ne i kemi thënë që na duhet noteri tjetër i cili na kishte përpiluar kontratën, por ai është përgjigjur se vetëm ai është noteri i kësaj zyre, ne e kemi njoftuar për marrëveshjen që e kishim bërë në këtë zyre, por i njëjti nuk kishte pas njohuri se ku është bërë kjo marrëveshje mbi kontratën e përpiluar. Pasi që jemi njoftuar në zyrën ku e kemi bërë kontratën se personi i cili na kishte përpiluar kontratën nuk është noter dhe atë e kemi mësuar nga noteri S.Sh., ne menjëherë kemi shkuar dhe e kemi hapur rastin në Polici. Në pyetjet e parashtruara nga prokurori i shtetit dëshmitarja është përgjigjur se kemi përpiluar një kontratë për një banesë në kompleksin G.R., dhe atë e kemi përpiluar me T.L.n, por këtë banesë nuk e kemi marrë, sepse nuk ekziston lidhur me atë kontratë që e kishim nënshkruar. Pos dëmin që është i precizuar në shume prej 37.000 (tridhjetë e shtatë mijë) Euro por edhe shpenzimet për të udhëtuar nga perëndimi për në Kosovë, për seancat gjyqësore na janë shkaktuar shpenzime të mëdha .Në pyetjet e parashtruara nga mbrojtësi i të akuzuarit F.Sh., av. Burhan Qosa, dëshmitarja përgjigjet se në momentin që kemi ardh në Kosovë në fund të vitit 2019, dhe kur e kemi kuptuar nga Noteri S.Sh., tani i pandehuri F.Sh., nuk është noter kemi shkuar në polici me bashkëshortin L.Sh. dhe kemi hapur rastin për Mashtrim që na është bërë lidhur me banesën që e kemi blerë.

Deklarata e dëshmitarit L.J.

Dëshmitari L.J., në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 18.05.2022, ka deklaruar se është e vërtetë se veturën për të cilën po dëshmoj, veturën e ka blerë në vlerë prej 15.000 Euro, (pesëmbëdhjetë mijë euro) pa doganë pastaj të njëjtën e kam doganuar në vlerë prej 4000 Euro, dhe regjistruar në emër të prindit S.J., gjithsej ka kushtuar 19.000 Euro (nëntëmbëdhjetë mijë euro). Pasi jam njoftuar nga policia lidhur me rastin që me këtë veturë nuk është diçka ne rregull, kam shkuar në Sallonin ku e kam blerë tek Auto Salloni “ E. ” në Lipjan, e kam dorëzuar veturën dhe më janë kthyer parat. L.Sh. më ka shkruar ne Facebook dhe më ka thënë se është një problem se vetura është e vjedhur, dhe unë i kam thënë se e kam blerë në mënyrë te rregullt. Veturën që e

kamë blere e kamë gjet përmes internetit dhe për doganimin e veturës nuk kam pasur ndonjë problem ndërsa sa i përket verifikimit se është bërë nuk jam në dijeni.

Deklarata e dëshmitarit S.Sh.

Dëshmitari S.Sh., në seancë e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 09.06.2022, ka deklaruar se për rastin që jam ftuar të dëshmoj kam dhënë deklaratë në polici dhe e mbështes në tersi atë që e kam deklaruar. L.Sh.n, para këtij rastit nuk e kam njohur, por pas këtij rasti e njohë kurse personat që janë prezentë, T.L., ka qenë palë e jona, ndërsa F.Sh., ka qenë punëtorë tek unë para këtij rasti, por pas një viti përsëri ka filluar të punoj tek unë dhe ende punon. Unë me profesion jam noter dhe zyra e punës është publike dhe T.L., ka qenë klient që ka ardhur për punë të veta personale, ka kryer edhe punë të tjera që i kryen secili qytetar, autorizime, kontrata të shitblerjes etj. Mua më kujtohet për kontrata që kanë të bëjnë me automjete mundë të ketë kryer edhe kontrata të tjera. L.Sh., ka qenë në zyrën tonë me bashkëshorten e tij, për të u informuar për një kontratë për një banesë që e ka blerë tek G.R., ku më ka treguar kontratën, mbi shitblerjen e një banese. E kam shikua që nuk është kontratë që është lëshuar nga zyra ime, i mungon logoja, as emër noteri, as nënshkrim noteri, as vulë noteri, e kam lexuar kontratën dhe i kam dhënë edhe këshilla, e kam parë që këshilla kishte edhe në kontratë me një dispozitë të caktuar, që marrëveshja do të behet tek noteri. Nëse ndihet i mashtruar i kam thënë që mundë të udhëzohet në Gjykatë, po ashtu më ka thënë se si ndërmjetësues ka qenë daja i tij, po ashtu më ka thënë se në telefon ka biseduar me T.K., që i ka thënë po në rregull është dhe mundesh me ble ketë banesë, unë nuk e kam vazhduar më gjatë, e kam udhëzuar që nëse ndihet i mashtruar të vazhdoj procedurë në Gjykatë, pasi që e njëjta nuk është bërë tek unë kjo kontratë, por Ligji mbi noterin na udhëzon që ti këshilloj palët. Nuk më kujtohet saktë se L.Sh., a e ka prezantuar këtë kontratë a është e njëjta por e di që nuk e ka pas asnjë element të kontratës se noterisë dhe nuk kam diskutua se për cilën banesë bëhet fjalë dhe nga kush e ka blerë, në momentin kur e kam vërejt që nuk është e lëshuar nga zyra ime nuk e kam diskutuar me gjatë. Nuk më kujtohet saktë por ka mundë të diskutohet që sipas kërkesës se tije, se kontrata është përpiluar nga F.Sh.. Në momentin kur ka ardhur i dëmtuari L.Sh., në zyrën time është paraqitur shumë artist (në momentin që ka hyrë në zyre ka qenë shumë i ngarkuar më ka thënë a je ti F.Sh., edhe pse besoj që e ka ditur që unë jam noter S.Sh., pasi ka qenë hyrja e pajisur me Logo, pa ju përgjigjur unë me ka thënë a s'je ti F.Sh., unë i kam thënë ulu dhe sqaro çka është puna, por i njëjti ka kërkuar të takohet me F.Sh.n, por unë e kam njoftuar që F.Sh., nuk punon në zyrën time, kjo mu ka dok mu artistike si me skenar). Nuk e di a më njohin të gjithë qytetaret si noter, por unë kam një volum të madhe të punëve me aktivitetin tim në periudhën dhjetëvjeçare, kemi pas mbi treqind mije lëndë, dhe nuk e

di se a më njohin të gjithë apo jo, por identifikimi im është në rrjete sociale, regjistrat publik të Ministrisë, logo në hyrje të përberë prej tre(3) logoje, me emër mbiemër emër të babës, dhe realisht është rregull që secila zyrë noteriale në të gjithë botën të ketë logo, edhe kontratat duhet të ketë logo nëse e ka përpilua ai noter. Sa më kujtohet personi ne fjale L.Sh., më ka thënë se noterin F.Sh., e ka identifikua përmes rrjeteve sociale, më herët u përgjigja për dyshimin artistik, pasi mua po me thotë e kam identifikua në rrjete sociale ndërsa në zyre po me drejtohet me F.Sh., mu ka dok si aktrim për të sigurua një provë për këtë gjykim, sepse në rrjete sociale e identifikova ndërsa fizikisht mu drejtua a je ti F.Sh.. Në vazhdim prokurori i shtetit i parashtron pyetje dëshmitarit Pyetje: Në polici në deklaratën tënde me datën 27.02.2020 në faqen 2 tek rreshti i 9 ju keni deklaruar se i dëmtuari L.Sh., ju ka drejtuar me fjalët (“nga personi me emrin T.L., me ndërmjetësim të dajës së T.L.t, e ka blere një banesë, dhe se F.Sh. ia ka përpiluar një kontratë qe e ka lexuar kontratën, dhe ka menduar se është kontrate noteriale “ a qëndron kjo ? Përgjigje : Ka pas mundësi të behet ndonjë gabim teknik në përpilim, pasi siç ceka më herët para pyetjes se prokurores, ai ka deklarua qe ndërmjetësues ka qenë daja i tij. Përveç këtij gabimi teknik, pjesën tjetër të deklaratës e mbështesë. Pyetje : Bashkëshortja e të dëmtuarit a ju ka thënë që edhe F.Sh., ka qenë prezent kur është lidhur kjo kontratë mes T.L.t dhe tyre ? Përgjigje : Nuk me kujtohet. I lexohet deklarata e dhënë ne polici tek rreshti 20 i faqes se 2 , “ Me pas bashkëshortja e tij me ka thënë se kinse F.Sh., e ka përpiluar dhe i ka thënë se kur behet pranimi teknik, kontratën do ta bëni tek noteri dhe do ta regjistroni ne kadastër “ Pyetje: A qëndron kjo a ju kujtohet ? Përgjigje : I mbështesë fjalët e mia që i kam thënë në këtë deklaratë. Pyetje : Përveç në zyre a jeni takuar di kund tjetër me te dëmtuarit ? Përgjigje: Po jemi takuar, me kërkesë të dajës se tij Nj.Sh., të cilin e kam pasur koleg ne polici, ka kërkuar shoqërisht me u taku me i dhënë këshilla juridike, po ashtu i njëjti ka qenë edhe në shtëpinë e F.Sh.t, mendoj qe ka qenë për me sigurua prova për gjykatë. Pyetje : A e din për çka u kanë aty ? Përgjigje : Nuk e di Pyetje: Ju theksuat që F.Sh., ka punuar tek ju, a të kujtohet periudha dhe çfarë pozite ka pas? Përgjigje: Ka punuar zyrtar ligjor, nder juristet më të mirë që kam pas në zyre, ndërsa periudhën nuk më kujtohet saktë, por e di që një (1) vit nuk ka punuar ne zyrën time viti nuk me kujtohet, me vendim të Odes së avokateve, ka punuar në një zyre të avokatisë, dhe gjatë kësaj periudhe, asnjëherë nuk ka pasur qasje ne zyrën time, pasi është e ndaluar edhe me ligj, këtë e dëshmoj me çdo kompetencë e sidomos për periudhën që po dëshmoj për lëndën. Betohem penalisht dhe materialisht që në këtë periudhë F.Sh. s’ka punuar në zyrën time, ky akt nuk është punuar në zyrën time, s’ka mundësi realisht fizike, nuk ka pas mundësi pa prezencën time punëtorët me përpilua këtë kontratë, apo a e ka përpilua apo se ka përpilua në ndonjë zyre tjetër unë nuk e di, por në zyrën time garantoj që nuk është përpiluar dhe jap përgjegjësi në çdo kohë por dua të shtojë që në zyrën që ka punuar F.Sh., si praktikant i Odës

se Avokateve, është afër zyrave tona saktësisht në atë zyre të avokatisë jam unë për momentin pasi kam ndërruar zyrën e punës. Pyetje : Tek cili avokat ka punuar F.Sh. ? Përgjigje : Te zyra juridike ku punon bashkëshortja ime E.Sh. dhe V.H.. Pyetje: Si është orari i punës i noterisë tek ju ? Përgjigje : Punojmë prej orës 08:00 deri ora 16:00 çdo ditë të javës prej të hënës deri tek e premtja, por me raste te ndonjë urgjence punojmë dhe jashtë orarit. Pyetje : Ne zyrën ku keni punuar në atë kohë a ka pas punëtorë dhe sa kanë qenë ? Përgjigje: 10 kanë qenë me aq sa e di por tani është numri me i madh. Pyetje: Në ditë vikendi nëse punoni ne ndonjë urgjencë, a dilni ju në punë apo ndonjë punëtorë ? Përgjigje : Po dal vetëm unë personalisht pasi unë jam i ngarkuar me vullë zyrtare, te premten pas përfundimit te orarit te punës, vullën e marr me vete pasi qe e kam kacën e caktuar për siguri, dhe nuk munde të ketë qasje askush tjetër. Pyetje : A po e dini se për cilën banesë po bahet fjalë, në kontrata a e keni klient G.R.? Përgjigje : Po është klient i rregullt, dhe për çdo kontratë që kryhet tek ne kemi dosje të veçantë, pasi është obligim ligjor te kemi arkiv me që pas përfundimit të mandatit si noter ato dorëzohen ne gjykate. Pyetje : Pasi po thoni që keni dosje për secilin rast, për këtë rast qe jemi për momentin këtu qe e ka blerë i dëmtuari prej te akuzuarit T.L., a keni dosje ju ? Përgjigje: Me sa me kujtohet dosjen e klientit e kam, lëndë qe janë vërtetu janë në arkiv, por saktësisht nuk e di për këtë lëndë, ndoshta u shit ndoshta nuk u shit, megjithëse dosjen e klientit, klienti e ka edhe ne faqen e vet, mundesh me hy me pa me këqyr me shtyp krejt dosjen e tij, sepse çdo ndërtues e ka në faqen e tij, po ashtu këto dosje munden të i kenë edhe avokat sepse edhe avokatët përpilojnë kontrata edhe për Banesa, sidomos prej poseduesve, për çdo ditë që vinë palët në zyrën time, sjellin kontrata që kanë përpiluar tek avokatet. Pyetje : Ne deklaratën e dhen ne polici faqja 4 pyetja e parafundit, Pyetja ju është bërë a ka pas kontratë për shitblerjen e banesës në procesin e ndërtimit për banesën në objektin 3 kati 5 banesa ... me sipërfaqe 125.24 metër katror e cila është në pronësi te G.R. 2 në mes të personit përgjegjës F.R.1. dhe T.L. , Përgjigjja juaj ka qene : “ Me sa me kujtohet F.R.1. dhe T.L. kanë pas kontrata për dy banesa, por me qenë i sigurt e shfletoj arkivin dhe ia sjell kontratën”. Pyetje : A Qëndron kjo ? Përgjigje : Siç kam thënë ashtu qëndron me aq sa me kujtohet. Pyetje : Dëshmitarë në momentin qe e keni kuptua këtë rast a ke diskutua me F.Sh.n për këtë çështje ? Përgjigje : Po kam biseduar me F.Sh.n, e kam pyetur mos e ka bërë këtë kontrate ne zyrën ku ka punuar ne zyrën e Avokatit , dhe më ka thënë që nuk me kujtohet, por edhe një herë e deklaroi tek unë assesi nuk është përpiluar nuk ka pas asnjë shans. Dua të njoftoj gjykatën që kam bërë një kërkesë gojarisht qe policia të vijë në zyrën time ti merr kamerat që incizojnë 24 orë, por mu kanë përgjigj që është kohë e gjatë dhe nuk mundë të marrim një veprim të tillë.

Në pyetjet e parashtruara dëshmitari S.Sh. nga mbrojtësi i të pandehurit F.Sh., av. Av.

Burhan Qosa, është përgjigjur: Pyetje: Dëshmitarë ju sapo deklaruar se para se klienti im F.Sh. te regjistrohej në zyrën e Avokates se cekur si praktikant, ka punuar në zyrën tuaj a është e vërtetë ? Përgjigje: Po, Pyetje: Ju po ashtu keni deklarua se pasi që e ka krye praktikën, prapë është kthyer F.Sh. në zyrën tuaj si punëtorë a është e vërtetë kjo ? Përgjigje: Po pasi e ka krye praktikën në Odën e Avokateve, i njëjti është kthyer prapë për të punuar në zyrën time. Pyetje: Ju po ashtu deklaruar se në zyrën tuaj i vetmi Noter i licencuar jeni ju a është e vërtetë ? Përgjigje: Po, dhe sipas udhëzimeve e kemi obligim të i bëjmë njoftimet prej para hyrjes , me reklamën me emër të babës e te gjitha. Pyetje: Ju deklaruar që në zyrën tuaj para se ta hapni keni vendosur 2 reklama ku jeni identifikuar si individ me emër mbiemër dhe emër të babës, po ashtu keni deklaruar se me sa ju kujtohet në kohën kur s'ka qenë F.Sh. në punë i keni pas në punë rreth 10-12 persona a mundë të na thoni, në kohën kur ka qenë F.Sh., para vendimit si praktikant, dhe sot përafërsisht sa punëtorë i keni ? Përgjigje: Sot i kemi diku 24 punëtorë, kurse në kohën kur ka punuar F.Sh. nuk më kujtohet saktë se sa ka qenë numri por ka mundë të jenë deri në 10 punëtorë. Pyetje: Për kohën sa ka qenë F.Sh. në punë tek ju, si para kohës kur ka ushtrua profesionin e praktikantit si dhe tash, a mundë të i thoni gjykatës emri i F.Sh.t, a identifikohet si Noter në çfarëdo forme qoft , përmes ndonjë logo apo diçka tjetër ? Përgjigje: Jo i licencuar jam vetëm unë te tjerët janë zyrtarë, praktikant, administratë, sajnë të identifikuar përveç që kanë detyrim që ID me emër mbiemër ta mbanë secili zyrtar bezhin ta vendos në qafe gjatë punës në zyre. Pyetje : Ju thoni që punëtorët e juaj janë të obliguar te mbajnë kartën e identifikimit (begjin) gjatë identifikimit te punës, a e respektojnë punëtorët këtë rregull? Përgjigje : E kanë obligim gjatë kohës së punës përveç pauzës e kanë të obliguar ta mbajnë. Pyetje : A e ka për momentin F.Sh., kartën e identifikimit ? Përgjigje : Po. Pyetje : A ka ndonjë foto karta e identifikimit apo vetëm emri mbiemri i personit ? Përgjigje : Emri mbiemri dhe pozita qe mbanë jo fotografi. Pyetje: Ne rrjetet sociale kur e keni hap zyrën e noterisë a keni publiku fotografi tuajat, a e keni ndryshua fotografinë apo është ajo gjithnjë ? Përgjigje : Po është e njëjta fotografi që e kam publikuar prej që jam Noter. Pyetje : Nëse është e mundur a kishe mundur me vullnetin tëndë me sjell foton gjykatës deri ne seancën e radhës foton së bashku me shënimet tjera siç i keni publikuar ne rrjetin social ? Përgjigje : Po Pyetje : Ju thatë që e keni kacën në shtëpi, çdo të premte e merrni vulën dhe e vendosni në atë kacë për siguri, në të gjitha periudhat prej që e njehë e deri me sot a ka ndodhë ndonjëherë që F.Sh. ta merr vulën e me shkua me punua pa lejen tende ne zyrën tende ? Përgjigje : Jo dhe zyra ime pas orarit nga e hana dhe e premtja apo pauzës 12:00 h -13:00 h, nuk ka mundësi te këtë çasje dikush në zyre të shtunën të dielave festave , nuk ka mundësi të e hap dikush pasi është e mbyllur. Pyetje: A ndodhë në zyrën tënde me u leshu një parashtrësë, kontratë autorizim apo çfarëdo veprimi tjetër, a mundë te lëshohet pa logon tende, nënshkrimin tëndë dhe me logo te noterit ? Përgjigje: Noteri e ka

obligim me nënshkrua çdo faqe të kontratës, secilën shtojcë të kontratës, me vulosë, me leshu kuponin fiskal, dhe me u arkivua, ne i kemi të deponuara nënshkrimin dhe shenjat e vulave tek Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj është obligim ligjor. Pyetje: ju si noter a mundë të i thoni gjykatës, kontratat formularë a dallojnë prej kontratave që i përpilojnë avokatet, a keni standard që mundesh me dallua kontratën tënde prej një kontrate të avokatit? Përgjigje: Në bazë të udhëzimit administrative në faqen e parë të kontratës duhet të jetë stema e RKS, duhet të jetë e shënuar me sfond 16 Republika e Kosovës , me sfond 14 Noter , me sfond 12 adresa e zyrës , dhe numri rendor dhe referenca e aktit, kjo me pas lidhen mes vetë faqet edhe shtojcat origjinali rrinë në zyrën e noterit ndërsa palëve i epet një ekstrakt që është konform origjinalit por këto forma tonat ose këto kontrata tona i kanë edhe palët por këto forma tona janë furnizua edhe kandidatet për provim të jurisprondencës që kanë ardhurë në zyrën tonë, pa shënime të palëve, ju kemi afrua ju kemi dërgua në email , dhe këto forma pa logo të noterit mundë të ketë secili avokat apo qytetar, si formë si përmbajtje mundë ta ketë secili pasi mundë të bartet. Pyetje : Ju thatë që lidhen faqet mes vete në një kontratë, si behet lidhja e tyre ? Përgjigje : Çdo kontratë faqe që lidhet me faqen tjetër i vendosim vulë në mes, lidhen mes vete, e qesim vulën në funde të kontratës , dhe e lëshojmë një ekstrakt të lidhur dhe të vulosur. Pyetje : Dëshmitarë a i kapni kontratat faqet e tyre me ndonjë metal special që është e lejuar vetëm noterit të i kap me to ? Përgjigje : Jo. Me lejen e gjykatës avokati av. Burhan Qosa i ofron kontratën e datës 17.08.2019 dhe e pyet se a dallon kjo kontrate mes atyre noteriale në kuptimin e përpilimit ? Përgjigje : Po, pasi ne i kemi të veçantë sepse secila kontrate që përpilohet tek noterit e ka te obliguar të ketë logo nënshkrim Pyetje : Ne zyrën tendë ne kompjuter tendin si Noter , a ki të ruajtura ne softwer lloj të kontratës që sapo ta prezantova ? Përgjigje : Jo nuk kemi te drejte ne te bëjmë kontrata private, dhe nëse dëshmohet për 10 vite pune që ka dal një akt privat nga zyra ime, unë jap përligjësi, sepse nuk është në mandatin tone, ne i kemi format noterit është zyrtar shtetëror dhe s'mundet te lëshoj akte private. Pyetje: Dëshmitarë a është e vërtetë që në momentin që pala e dëmtuar ta ka propozua atë kontrate, ju i keni deklarua që kjo kontratë s'është bërë në zyrën tuaj ? Përgjigje: i kam treguar që kjo kontratë nuk është përpiluar në zyrën time, me tha që e ka te kryer universitetin- fakultetin dhe unë e kam pyetur a ka kryer ndonjëherë ndonjë akt noterial në shtetin e Gjermanisë më ka thënë që po, dhe i thash a ke pa që ka formë, logo, nënshkrim, rreth formës nuk mu ka përgjigjur.

Ne pyetjet e parashtruar nga gjyqtari i vetëm gjykues dëshmitari S.Sh., është përgjigjur: Po kanë qenë në zyrën time, jam takuar edhe pas këtij rasti edhe dy herë të tjera, njëherë për tu këshilluar dhe një herë në shtëpi. Unë i kam udhëzuar që nëse ndihen të mashtruar nga ndokush e ka te drejtën e tij të vazhdoj në polici dhe gjykatë, me ka njoftuar ne lidhje me F.Sh.n, më ka

thënë që e ma ka përpiluar kontratën F.Sh., por ku e ka përpiluar nuk ka qenë i qartë, me që kanë qenë në afërsi në mes të avokateve dhe noterit. Më ka njoftuar që atë kontratë që banesën e ka blerë nga T.L., dhe atë kontratë i njëjti ma ka ofruar dhe e kam vërejtur që nuk ka të bëjë asgjë me noterin. Por nuk me kujtohet se a ka qenë e nënshkruar apo jo, si e kam parë që s'ka logo s'jam lëshuar me tutje. kemi raste që paraqiten palë që kanë përpilim të kontratave por si e shohë që s'është e përpiluar nga unë, i drejtoj që të shkoj aty ku e kanë përpiluar. Kam biseduar me F.Sh.n lidhur me veprën që akuzohet, e kam pyetur rreth çështjes se përpilimit të kontratës se a e ka përpilua këtë kontratë si praktikant në zyrën e avokateve, kesi kontrata, dhe me është përgjigjur se kam mundur të përpiloj forma tjera, por për rastin konkret nuk ju ka kujtua, nuk me kujtohet a e kam pyetur se a ka marr ndonjë shume të pagesës për përpilimin e kësaj kontrate.

Deklarata e dëshmitarit F.S.

Dëshmitari F.S., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 09.06.2022, ka deklaruar se jam në dioni për rastin që do të dëshmoj, pasi që për këtë rast kam dhënë deklaratë në prokurori, por data tani nuk më kujtohet, personin që është prezent si i dyshuar T.L.n e njoh pasi që e kanë njohur përmes të afërmeve të tij kushërinjve të tij, sepse kam ndërtuar objekte sepse aty afër e kam edhe pasurin time të paluajtshme. Veturën Audi A6 të vitit 2014, e kam blerë nga T.L. dhe atë me datën 26.08.2019 në sallonin tim të veturave. Ku herën e parë kemi rënë në kontakt me viber ma ka propozua veturën kam qenë i interesuar me ble ma ka prurë të pllaci dhe e kam blerë, por para se ta blejë e kam vërtetuar se a është e çlajmruar pastaj e kam blerë. Për blerjen e veturës kemi arritur ku çmimi ka qenë (15) pesëmbëdhjetë mijë euro, por unë e kam blerë në vlerë (14) katërmëdhjetë mijë euro, por ka qenë e pa doganuar e lajmëruar por, çmimin real të tregut e ka pas (15) pesëmbëdhjetë mijë euro. Parat shitësit të veturës T.L.t i'a kam dhënë në Sallonin e veturave kur i kam dhënë parat pos T.L.t askush tjetër nuk ka qenë. Veturën para se ta blejë e kam verifikuar tek djali dajës në Gjermani në Munhen, dhe i kam bisedat screen bisedat me to se kur u çlajmru vetura nga pronari, se pa u çlajmru vetura nuk doganohet në Kosovë, pa ardh dy librezat e Gjermanisë, në momentin që e çlajmron pronari vetura deklarohet që u shit ashtu i pet edhe deklarata në Gjermani. Kurë e kam blerë veturën prej T.L.t e kemi shkruar një marrëveshje me dorë ku është nënshkrimi dhe pasaporta e T.L.t, por kam gabua pa dashje nuk e kam cekur vlerën e blerjes. Pas blerjes së veturës unë e kam shitur sepse e kam biznes dhe atë e kam shitur tek Auto Salloni Lipjani në vlerë prej (15) pesëmbëdhjetë mijë euro 15 mijë euro, dhe atë E.S.. Unë nuk e kam përdorë këtë veturë kur e kam blerë sepse ka qenë e çlajmruar dhe pa doganuar. Në vazhdim të dhënies së dëshmisë prokurori i shteti me lejen e Gjykatës e ballafaqon me deklaratën e datës 05.02.2020 të dhënë në polici, ju keni

deklaruar : “ Pas verifikimit T.L. e mbante katërbëdhjetë (14)mijë euro , pastaj u morëm veshë për trembëdhjetë (13) mijë euro “ Cila është e vërteta ? Përgjigje: Kjo që e them tani është e vërteta sepse ka mundur te jete gabim teknik. Pyetje : A e keni lexuar deklaratën qe e keni dhënë ne polici dhe nënshkruar ? Përgjigje : Po .Në deklaratën e dhënë në polici faqja e 2 rreshti 9 ju keni deklaruar se : “ Paratë ja kam dhënë kesh T.L.t prezent kanë qenë vllau tij dhe vllau im Tahiri “ kështu keni deklaruar ne polici ? Cila është e vërteta sepse ju sapo deklaruat që jeni kanë veç ti e T.L.. Përgjigje : Vellau im rrinë nënë stop aty edhe baba edhe motrat, por nuk e pash të arsyeshme i theksova gjithë këtu, sepse marrëveshjen e kam bërë, unë e T.L. dhe të tjerët kanë marr pjesë.

Përfaqësuesi i te dëmtuarit Av. Avni Ibrahimimi, në pyetjet e parashtruara dëshmitarit F.S. është përgjigjur se, unë e kam njohur T.L., përmes kushërinjve të tij, sepse T.L. ka punuar tek i njëjti qe jam kam ndërtuar unë objektin.

Dëshmitari F.S., në pyetjen e parashtruar nga gjykata ka deklaruar se veturën që e ka blerë nga T.L., ka qëndruar tek unë vetëm një ditë sepse e kam shitur menjëherë në Sallonin Auto Lipjani , nuk kam ditë asgjë qe ka ndodhe lidhur me këtë, sepse ka shkua gjithë çka në rregull me pagesën e me të gjitha i'a kam shit pesëmbëdhjetë mijë euro dhe atë se çfarë ka ndodhur me veturën ne fjale jam njoftuar nga policia dhe kam dhënë deklaratë lidhur me rastin. Unë e njoftoj gjykatën se nuk më ka ndodhur asnjëherë edhe pse merrem me këtë punë, që vetë pronari me çlajmru veturën dhe deklaroi në shtetin e Gjermanisë që e ka shitur veturën, edhe njëkohësisht e lajmon veturën që është marrë me mashtrim. Veturën qe i akamë shitur Auto Sallonit Lipjani, unë i'a kam kthyer parat pronarit të Auto Sallonit në fjalë sepse nuk doja të kishim telashe. Mirepo e njoftoj gjykatën vetura ishte e doganuar në qytetin e Bujanovcit në Serbi, momentin që e ka thirr policia atë djalin, ai nuk ka dashtë me u mirë me telashe, dhe unë i'a kam kthyer parat. Kam shkuar në Serbi, dhe e kam çlajmru veturën, i kam marr dokumentet mbrapa, mua mu ka dok që ai djali i Preshevës është duke ba dallavere, se kur kamë ardhur me doganu veturën në Kosovë, ska pas problem, pasi që unë e kam kryer doganimin regjistrimin sepse realisht sistemi doganës është, nëse në veturë lypet prej Interpolit ta ndalin veturën. Dhe pastaj unë këtë veturë i kam shitur një personi nuk ja di emrin dhe ska pas problem, ku për veturë është vlerësuar doganimi pesë(5) mijë euro, pastaj këtë veturë e kamë shitur në vlerë prej njëzet mijë euro, por jam njoftuar se kjo veturë është konfiskuar më vonë në Mal të Zi ,nga personi që e ka blerë prej atij ajo veturë i'u është konfiskuar pronarit, e cila gjindet ne Mal te Zi në Stacion Policor ku tani po po mi kërkojnë parat të i'a jap , sepse ne aspektin e shitblerjes jam dora e parë e kësaj veture, dhe unë e njoftoj gjykatën nuk kam paguar asgjë deri me tani, po e pres verdiktin e Gjykatës.

Deklarata e dëshmitarit D.A.

Dëshmitari D.A., në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datën 09.06.2022, ka deklaruar se T.L., e njoh por dhe atë hera e parë që jemi takuar në H.P. në Ferizaj, ku kamë qenë me dajën tim L.Sh.n, ka pas edhe persona të tjerë, prezent dhe arsyeja që jemi takuar me T.L.n ka qenë rrethë blerjes se një banese por nuk kamë pasur dijeni për cilën banese behet fjale por aty është biseduar rreth çmimit , dhe me sa me kujtohet aty kanë arritur marrëveshje, L.Sh. me T.L.n, ku kanë arritur marrëveshje për çmimin e banesës ku është llogaritur Vetura ne vlere prej 27 mijë euro Audi A6, dhe dhënia e parave kesh në shumë prej 10 mijë euro, totali gjithsej 37 mijë euro, dhe pas arritjes së kësaj marrëveshje në mesë L.Sh. dhe T.L.t, unë jam larguar nga aty dhe kamë shkuar në shtëpi por edhe L.Sh. kishte shkuar më vonë në shtëpi. Pas këtij takimi unë me L.Sh. kamë diskutuar rreth kësaj marrëveshje pasi që arsya e involvimit tim ka qene konkretisht, kur mi ka transferua 10 mijë euro kesh përmes bankës L.Sh. ne Raifaisen Bank ku janë edhe regjistrat, për t'a dorëzua T.L.t pasi që ishin marrë vesh që me rastin e blerjes së banesës pos veturës që i kishte dhënë kishte me i'a dhënë edhe dhjetë (10) mijë euro kesh, ku pasi L.Sh. i kishte bartur në gjillogarin time përmes gjillogarisi së bashkëshortes së tij ku edhe i kam tërhequr, ku jemi takuar në H.P. me T.L.n, dhe ia kam dhënë dhjetë (10) mijë euro ku ju njoftoj këtu në seancë gjyqësore se bëhet fjalë për personin që është prezent T.L.t, ku kemi pirë, ndërsa dorëzimin e parave ia kam dhënë ne veturën e tij brenda, të cilën e kishte parkuar në parkingun te H.P., ku isha vetëm unë dhe T.L. ku pastaj e kamë njoftuar edhe L.Sh.n se parat në shumen e cekur i'a ka dorëzuar T.L.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar L.Sh., av. Avni Ibrahim, i parashton pyetje dëshmitarin D.A., ku dëshmitar është përgjigjur se nuk i kujtohet data dhe koha se kurë për herë të parë ka biseduar me T.L. , por pranimit të hollave data nuk më kujtohet por i'a kamë dhënë të hollat në shumën që ceka më parë edhe qelsin rezervë te veturës Audi A6 , por jo ate dit por disa dite më vonë ndoshta ka qene një jave pasi ia kam dhënë te hollat.

Mbrojtësi i të pandehurit F.Sh. av. Burhan Qosa, në pyetjet e parashtruara dëshmitarit D.A., është përgjigjur, se kur është bërë marrëveshje me T.L. ,ka qenë mbrëmje .Dëshmitarin N.N., e njoh pasi ka qenë prezent në H.P. kurse dëshmitarin L.A., nuk e njoh.

Deklarata e dëshmitarit F.R.I.

Dëshmitari F.R.1., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 26.07.2023, ka deklaruar se për rastin që o dëshmoj në polici, kam dhënë deklarate dy here dhe nuk me kujtohet për cilin rast, sepse dhe me herët kam dhënë deklarate në polici për raste të ngjashme për personin i cili është në cilësinë e të pandehurit, për këtë rast saktë nuk e di a kam dhënë, dhe as datat nuk me kujtohen , me kujtohet i dëmtuari dëshmitari L.Sh., nuk me kujtohet qe kam dhënë deklarate sa i përket çështjes se këtij personi, por atë qe e kam thënë në deklarate në polici i qëndroj mbrapa. Unë siç deklarova në fillim se punoj me ndërtimtar objekte banesore, objekti im banesor quhet G.R. SHPK dhe gjendet përball gjykatës se re Rruga ..., si kompleks i përfshin .. hyrje, . komplekse janë të përfunduara ndërsa objektet .. dhe .. janë në përfundim e sipër, shumica e banesave janë të shitura diku 98përqind , dhe marrëveshjet e shitblerjes behet me kontrate e vërtetuar tek noteri , dhe unë zakonisht kontratat i beje tek noteri S.Sh., por ka pas raste qe kam bere edhe tek noter tjerë ose me preferencën e palëve ku ata propozojnë , sa i përket noterit S.Sh. e ka afër zyrën komplekseve banesore G.R.. Kontratat te cilat lidhen mes palëve duhet te jene prezent : Blerësi dhe Shitësi, në këtë rast une si shitës dhe pala tjetër qe ka shprehe interes qe ta blejë banesën , sa i përket objektit që po me pyetni objekti 3 ka qene i ndërtuar por nuk ka qene i përfunduar për vitin qe po me pyetni 2019 , konstrukti i ndërtimit te vrazhde ka qene i ndërtuar i përfunduar por një objekt quhet i përfunduar kur te kryen edhe punët e brendshme të një banese, sa i përket objektit 3 ka qene i përfunduar vetëm ne ndërtimin e vrazhde , ne këtë kompleks janë bodrumi qe përfshin garazhet përdhese 11 kate si dhe penthouse ne katin e sipërm. Secili kat i ka nga .. hyrje banesore , dhe madhësinë e kane me sipërfaqe te ndryshme , Sipas numrit me renditje për këtë sipërfaqe qe po me pyetni i bie kati i 8t , banesa .. gjendet ne katin e .., vlere e një banese me këtë sipërfaqe 125.24metra katror i bie di kund afër 70bmij euro. Personin i cili është i pandehur T.L.n e njohe, dhe e njohe si blerës ne kompleksin tim banesor , sepse ka blere banese prej nesh , besoj qe ka qene viti 2019 kur ka blere banese , nuk e di saktësisht se cilën por ekzistojnë kontratat noteriale e përpiluar tek noteri dhe te njëjtën e ka shit , ku çdo ndryshim prapë unë është dashtë që te jem aty për të lidh kontratën e shitblerjes kaq kam njohuri. Por për rastin qe po më pyetni nuk ka qenë tek unë për ndonjë marrëveshje asnjëra pale as T.L. dhe as L.Sh.. L.Sh. nuk e njohë me emër apo në detaje si person , por me kujtohet qe ky person nje dite prej ditësh është paraqitur tek zyrat e mia, dhe ka kërkuar te shikoj a është përfunduar një banese apo jo, dhe unë i kam thënë si e ka emrin, ne cilën kat dhe hyrje , unë e kam shikuar ne liste, dhe i kam thënë ne cilin kat ia kam treguar emrin e cilit person është kjo banesë, ai ishte ne zyre duke biseduar me zyrtarin e kompanisë time që ishte ne zyre zyrtari ka kontaktuar me mua për te u informuar për këtë banese , i kam thënë zyrtarit pyete personin a e ke blere prej nesh apo dikujt tjetër, ka thënë direkt prej jush jo por prej 1 personi tjetër, e kam kërkuar edhe me atë emër qe me

ka dhënë L.Sh. por skam mundur ta gjej, sepse këtu A. nuk kam që ka blerë banesë tek unë ndonjë marrëveshje apo diçka, dhe e kam pyetur se a ka ndonjë dokument me vete, me ka thënë po dhe jam kthyer nga rruga për tu takuar me to, dhe e pash para zyrës time duke me pritur, dhe jam takuar me te. Dhe pas takimit e pyeta L.Sh. prej kujt e ke ble banesën dhe i njëjti me tha një person me emrin A. i thash A. ka muajt me ta shit ty por e ka blerë prej ndonjë bashkëpunëtori ton dhe është në emrin e tij, i kërkova ndonjë letër apo diçka që me e evidentua, me tha e kam kontratën që u lidh tek noteri, hezitojke të më tregonte kontratën, dhe e nxori një kontratë pas konsultimeve me te sepse i thashë që jam pronari dhe nuk ka ndonjë të keqe sepse jam pronari legjitim dhe kam njohuri të dorës se parë sa i përket këtij kompleksi banesor. Kur më ofroi kontratën për ta shikuar si e kam shikuar kontratën dhe nuk e kam pa emrin tim që nuk është në atë kontratë, i thash kjo kontratë që ma ofrove s'paska as vulë, ku e ke bërë, me thanë tek noteri qetu afër, nuk ka pas as nënshkrim timin apo diçka, shko tek ai që e ke ble por kjo nuk është tek ne e bere, sepse mu dhimb si person ku i njëjti që ka bere pagesa, i thash pse nuk me kontaktove për blerjen e këtij objekti banesor, por i njëjti me tha që e ka bërë kontratën në mirëbesim, tani po e di dhe unë po drejtohem aty ku e kam lidhur këtë kontratë. Kemi qenë para objektit, por nuk kemi shkuar sepse nuk e dija as të cila banese as të cili person të paraqitemi, i njëjti përshkruante katin, unë gjithëherë kërkoj skicën e banesës dhe pas shikimit e njoftoj palën për punimet që janë duke u zhvilluar e gjithçka çka ka të bëjë me këtë banese i kam të gjitha shkresat për çdo banese dhe çdo të dhënë. Ai më tha që është këtu afër noteri, por emër nuk me ka dhënë, unë doja që të i ndihmoja por ai hezitonte dhe kur e pash hezitimin e tij sepse mendonte që po e mashtruj, e shihja që është në stres doja të i ndihmoja, por e pash që hezitonte dhe ai u largua në rrugën e vet. Skicën që e prezantove e benë arkitekti dhe e mbaj unë personalisht por nëse pale ma kërkon ja jap me shikua, dhe e di që noteri në mënyrë elektronike e merr skicën prej projektuesit që e kemi në si kompleks që kur të shkojmë në tek noteri për të bërë kontratën duhet të verifikuar mos po e shes dy here, ku noteri është i obliguar që ta shikoj a është e shitur me herët apo jo agjensionet e marketingut munde të i kenë, ata i qesin në rrjete sociale etj. Noteri është i pajisur direkt prej projektuesit që kur të bëhen marrëveshjet për ti i verifikuar të gjitha sa i përket asaj banese. Kur e pash kontratën i thash e ke përpilua tek avokati dhe jo tek noteri. Jam taku edhe herën e dytë me te ka qenë së bashku me bashkëshorten jemi takuar tek hyrja e banesës, me tha që i kam besua nuk e kam dit sepse me kanë të kisha kontaktua të kisha pyet ai më tepër e ka ndih veten të shqetësuar kur ka dal në rrjete sociale dhe lajme atëherë ka ardhur është interesuar i shqetësuar. Çdo palë para blerjes së banesës konsultohet me mua a ka ndonjë problem a përkthehet banesa në mënyrë të rregullt etj. T.L.t ia kemi shit dy banesa, njëren e ka blere prej operatorit Toni Kompani, kompani betoni, ndërsa tjetren prej meje, dhe nuk kam pasur ndonjë problem me te.

Banesën e par e ka blere me afat deri ne vit te ri nga operatori T. Kompani. Sa i përket banesës qe e ka blere tek unë e ka përfunduar dhe nuk ka lidhje me këtë rast, dhe obligimet financiare i ka përfunduar.

Mbrojtësja e të pandehurit T.L., av. Latife Neziri, i parashton pyetje dëshmitarit F.R.1., i cili në pyetjet e parashtruara është përgjigjur se me T.L.n kam pasur marrëdhënie kontraktuale, por për banesën që është objekt shqyrtimi nuk kam pasur.

Mbrojtësi i të Pandehurit F.Sh. av. Burhan Qosa, i parashton pyetje dëshmitarit F.R.1.,
Pyetje : Me sa noter ne Ferizaj bashkëpunoni ju për objektet e juaja qe bëni kontrata te shitblerjes? Përgjigje : Tek tre apo me shume por ne shumicën e rasteve pasi e kam me afër tek S.Sh.. Pyetje : Ju thate qe jeni i vetmi person qe jeni i autorizim për shitjen e banesave edhe ato kur blihen prej palëve qe ju paraprakisht keni pas mardhënje kontraktuale ? Përgjigje: Po është e vërtetë. Pyetje : Konkretisht tek noteri S.Sh., a bëni kontrata noteriale ? Përgjigje: Po. Pyetje : A keni mundësi te i thoni gjykatës cili prej noterëve i ka përpiluar me se shumti kontratat e objektit tuaj qe janë përball gjykatës ? Përgjigje: Tek noteri S.Sh.. Pyetje: Prej krejt banesave qe i ke shit a ka pas ndonjëherë ndonjë rast qe ka ardh dikush me u ankua që ka blerë banesën dhe e ka lidh marrëveshjen tek noter S.Sh. dhe ka ardhur ka thanë qe kam pas problem e kam lidh kontratën dhe ti s'je kanë nënshkrues ? Përgjigje : Jo asnjëherë absolut Pyetje: A ta ka përmend emrin e noterit S.Sh. kur ta ka tregu atë kontrate L.Sh.? Përgjigje : Jo Pyetje : Me kontratat e S.Sh.t kur ti i ke nënshkruar a ke pas ndonjëherë ndonjë problem ? Përgjigje : Absolut Jo Pyetje: Vizatimet teknike te objektit a i kanë agjensionet e patundshmërisë qe ju keni marrëveshje për shitblerjen e banesave ? Përgjigje: Po i kane te gjitha , por vizatimet ne te cilat ka shënime me shkrim i kam vetëm unë dhe nuk i ka askush. Pyetje: Me lejen e gjykatës kjo është vizatimi i banesës qe është e lidhur ne kontrate mes palës se dëmtuar dhe te pandehurit te pare, a është ky nënshkrimi yt ? Përgjigje: Jo këtë mundet ta këtë gjithkush nuk ka te beje me nënshkrimin tim.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. Avni Ibrahim i për dëshmitarin F.R.1. ka pyetje që ti parashtror ku gjykata e lejon Pyetje: Ne pyetjen e prokurorit ju thatë qe ne vitin 2019 ka qenë një kontratë e cila është përpiluar tek noteri, në të cilën ka qenë prezent edhe i akuzuari T.L., Përgjigje: Po ka qene prezent një kontrate tjetër jo për këtë qe jam këtu te dëshmoj Pyetje: A te kujtohet a ka qenë objekt i shitblerjes banesa ... me sipërfaqe 125.24metra katror qe është në katin e 5t prezent kane qene ne zyrën e noterit dhe është vërtetuar ajo kontratë me E.Q., te cilën ti e ke nënshkrua e cila banese në fillim ka patër kontratë qe i ka takuar Qenanit që pastaj është përcjell tek F.G.1, F.G.2. tek T. Kompani dhe T. Kompani tek E.Q.? Përgjigje : Këtë pyetje qe është

parashtruar nga avokati nuk ka lidhje me këtë objekt kontestues që jam këtu. Aty ku ka të beje T.L. nuk ka të bejë E.Q.. Pyetje : A të kujtohet kur ka ardh L.Sh. dhe ka kontaktuar me ju, dhe ju ka njoftuar që unë jam blerës i një banese ? Përgjigje: Po ka ardhur. Pyetje : A te kujtohet a te ka tregu ndonjë kontrate dhe a e ke shikuar ? Përgjigje: Po e kam shikuar Pyetje : A i keni thënë se kjo është falsë ? Përgjigje: Jo nuk i kam thënë që është falsë por nuk është e bërë tek noteri. Pyetje : A e mbështet deklaratën e dhënë ne polici, që i keni thënë L.Sh. kjo është e bërë tek noteri as te avokati dhe ju jeni i mashtruar dhe drejtohuni ne polici lajmëroni rastin sepse T.L. asnjëherë nuk e ka blerë këtë banese nga unë? Përgjigje : Është e sakte kjo që e kam deklaruar.

Deklarata e dëshmitarit E.S.

Dëshmitari E.S., në seancë e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 20.09.2022, ka deklaruar se për rastin që jam ftuar nga Gjykata jam në dioni pasi për këtë rast kam dhënë deklaratë edhe në prokurori dhe e mbështes në tërësi, është e vërtetë se e kam blerë një Veturë Audi A6 e vitit 2014, të cilën e kam blerë nga personi F.S. por data nuk më kujtohet se kur e kam blerë dhe sa më kujtohet i amë dhënë 12-13 mijë euro dhe të hollat i'a kam dhënë kesh ku i ka pas dy libreza dhe dy çelsa dhe të njëjtën ditë menjëherë e kam shitur personit L.J. por nuk më kujtohet se a i kam shitur me çmim më të lartë se sa e kam blerë ku unë e kisha blerë të pa doganuar, kurse L.J. e ka bërë doganimin dhe e ka bartur në emrin e tij personal. Nga personi F.S. që e kam blerë në lidhur me dokumentacionin e veturës ishte çdo gjë në rregull. Por pasi që Fatlumi më ka njoftuar se nuk është në rregull në i'a kam kthyer parat në tersi, kurse unë asnjë veprim procedural nuk kam marruar.

Administrimi i provave materiale

Fotokopja e kontratës për shitblerjen e banesës në procesin ndërtimor dt.17.08.2019; fotokopja e librezës së qarkullimit të automjetit "Audi A6"; Plani i banesës A-37, fotokopja e policës së sigurimit të mjetit nr.1...8 dt.17.09.2019; Kartela e sigurimeve valid deri më dt.17.09.2020; Karta ndërkombëtare e sigurimeve valid; Marrëveshja për shitblerjen të dt.26.08.2019, mesazhet-komunikuese të dt.26.08.2019; Dy fotokopje nga katalogu mbi shënimet për banesat e tjetërsuara për objektin 3 të dt.25.02.2020; Kontrata për shitblerjen e palujtshmërisë /banesës në procesin ndërtimor LRP.nr.1./2019 ref.nr....7/2019 dt.24.07.2019; Kontrata e punës së F.Sh. ,vendimi për regjistrim në OAK-ës;Të dhënat në lidhje me të kaluarën kriminale për të pandehurin T.L., foto dokumentacioni si dhe të bëhet vështrim në shkresat tjera përcjellëse të lëndës; dhe Shikimi i CD-së AKF ..., Raport të Ekspertimit nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë Numri ref. i AKF-së ... i datës 19.06.2023.

Mbrojtja e të akuzuarit T.L.

I pandehuri T.L., në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datën 02.11.2023, në pyetjet e parashtruara nga mbrojtësja e caktuar sipas detyrës zyrtare av. Latife Neziri, të mbrojturit të saj është përgjigjur: Pyetje a të kujtohet data kur je arrestuar për rastin për të cilin e vuan dënimin për veprën penale vrasjen? Përgjigjet se 12.12.2019, ku të njëjtën ditë më është konfiskuar telefoni i markës Iphone 11 pro Max, me numër, dhe e di që para se të më konfiskohet të njëjtin telefon e kam përdorur diku 5-6 muaj dhe telefonin për të cilin që është lidhur marrëveshja apo kontrata lidhur me shitblerjen e banesës me të dëmtuarin e këtij rasti ka qenë 17.08.2019, e këtë telefon e kam pas në përdorim dhe në vazhdim e njofton Gjykatën se telefoni për të cilin po flas numri ka qenë i njëjtë dhe telefoni i njëjtë, regjistrimi i të dhënave nga ky telefon barten në Icloud, dhe gjithçka ruhet në të dhe për rastin që po dëshmoj unë e di mirë që në telefon kam pasur dëshmi që lidhen komplet me rastin, kam pas me L.Sh., me F.R. edhe shumë persona të tjerë. Telefonin që më është konfiskuar dhe që jam gjykuar për rastin e vrasjes ka qenë i hapur telefoni nuk ka pas kod hyrës dhe ka pas mundësi të ketë qasje në telefon, por prej momentit që unë jam privuar nga liria dhe më është konfiskuar ky telefon unë nuk kam as qasje në të këtë telefon. Por pas njoftimit lidhur me raportin e Agjencisë së forenzikës së Kosovës, 2023-0229, e datës 06.06.2023, identifikohen dhe mund të vërehen komunikime në telefon deri më datë 26.05.2018. Pyetje: duke u bazuar nga raporti i pranuar a e din se çka ka ndodh me komunikimet e telefonit tënd pas datës 26.05.2018? Përgjigje: unë nuk kam dijeni se çka ka ndodh por kjo datë e fundit nuk përkon me rastin sepse marrëveshja është lidhur në vitin 2019, në vitin 2018 unë me L.Sh.n nuk kam pas kurrfarë kontakti me të. Pyetje: ju keni dhënë deklaratë lidhur me rastin në Prishtinë në QP, me datën 03.03.2020, a qëndroni pranë asaj deklaratë që e ke dhënë para policisë? Përgjigje: jo nuk qëndroj sepse në kohën kur jam marrë në pyetje nga policia e autorizuar nga prokuroria, kam qenë nën hetim dhe vazhdimisht në marrje në pyetje për rastin për të cilin jam në vuajtje të dënimit, dhe nga ngarkesa nuk më kujtohet se çka mund të kem deklaruar në ato çaste emocionale për mua, dhe 90% e deklaratës nuk më kujtohet. Unë e kam bërë një marrëveshje të shitblerjes së banesës në procesin ndërtimorë me blerësin L.Sh.t, por koha e saktë nuk më kujtohet, por banesa ka qenë e imja e cila ka qenë e një marrëveshje të lidhur në mes meje dhe pronarit të banesës F.R.1.. Unë kam pas bazë juridike pasi që i kam bërë pagesë pronarit, dhe gjërat që i kam kërkuar nga fillimi i procesit gjyqësorë kanë qenë në telefon. Unë deklaroj se me pronarin siç deklarova më lartë F.R.1., kam pas marrëveshje me shkrim, me vulë të firmës së tij dhe me nënshkrim personal timin, dhe me numër personal timin. Gjatë kohës kur unë jam arrestuar kam qenë me vendbanim në lagjen Iliria, dhe shumica e gjërave si kontrata, marrëveshje, dokumente, gjatë largimit të familjes sime, shumica janë humbur por ajo ka qenë e

fotografuar dhe është gjetur në telefonin tim personal. Unë kam pasur të drejtë që të shesë banesën në ndërtim e sipër që gjendet në kompleksin banesor objekti 3, kati 5, banesa 37, me sipërfaqe prej 125,24 m², ku pos kësaj kam pas marrëveshje edhe për 4 banesa të tjera, por të gjitha marrëveshjet i kam pas të fotografuara në telefonin tim personal, për banesat për të cilat po deklaroj unë i kam paguar, disa kanë qenë me para kesh disa me kompensim, ndërsa për banesën ... kati 5, me sipërfaqe prej 125,24m², kam dhënë para, ku 87% është paguar, dhe paratë në fjalë i ka marrë F.R.1., por nuk më kujtohet që dikush ka qenë prezent. Unë kam shitur banesa në objekte të G.R., prej 5 banesave që i kam pas, të gjitha janë shitur, 3 raste banesave që i kam shitur banojnë blerësit, por me dy banesa kam pas problem për rastin të cilin jam i akuzuar dhe për një rast tjetër. Banesën të cilën ja kam shitur L.Sh.t, unë atë banesë e kam paguar më herët, dhe në momentin që unë e kam vendosur që këtë banesë të i shes L.Sh.t, unë kam qenë pronar i saj. Kurë ja kam shitur banesën L.Sh.t, siç më kujtohet dy ditë rresht kemi bisedua rreth banesës, ku kemi qenë tek objekti, pasi që objekti ishte në ndërtim e sipër e kemi pa, po ashtu edhe planin origjinal që lëshohet vetëm nga pronari, ku atë plan e kam pas edhe unë të cilin ma ka dhënë F.R.1., në bazë të saj kemi arritur marrëveshje privatisht, marrëveshje gojore, pastaj nuk më kujtohet data e saktë por jemi konsultuar n mes vete me L.Sh. për rreth krejt ato marrëveshje gojore që i kishim bë për me i bart në letër. Unë i kam sqaruar L.Sh., sepse për ta bërë kontratën për shitblerjen tek noteri duhet të jetë pronari legjitim i autorizuar për shitblerjen e banesave dhe për arsye se unë isha në obligim prej 10%, të pagesës, ne kemi mund të bëjmë vetëm marrëveshje jashtë noterit. Me L.Sh. lidhur me blerjen e banesës në fjalë kemi arrit marrëveshje që ai të më jep një veturë të markës Audi A6 dhe 27.000 €uro, e nga kjo shumë përveç veturës mi ka dhënë 10.000 €uro, kurse pjesa tjetër ka mbet ende pa paguar, ku sipas marrëveshjes ka qenë se atë ditë lidhet kontrata te noteri atë ditë mi jep edhe shumën e mbetur prej 17.000 €uro. Unë njoftoj Gjykatën se nga blerësi L.Sh., kam marrë veturën e lartë cekur Audi A6 dhe shumën prej 10.000 €uro, ku me L.Sh. kemi bërë marrëveshje me shkrim, kontratën e kemi bërë tek avokatia E.Sh. nuk më kujtohet mbiemri, por e di që është bashkëshortja e noterit, por siç e di nga avokatja ka qenë i autorizuar F.Sh.. Pyetje: pse pala e dëmtuar pretendon që ju i keni i thënë se kjo kontratë është kontratë noteriale? Përgjigje: momentin kur është ngritur kjo akuzë unë kam qenë i privuar nga liria për veprën penale që jam gjykuar, dhe se pala e dëmtuar L.Sh., ka shfrytëzuar gjendjen time faktike për të i deklaruar ato për pyetjen që ma parashtroi mbrojtësja ime, sa i përket çështjes së noterit, kinse unë dhe tani F.Sh. jemi deklaruar se F.Sh. është noter, kjo nuk qëndron sepse atë ditë ka qenë prezent edhe bashkëshortja e L.Sh. dhe nga ana ligjore F.Sh. i ka treguar që kjo kontratë ka vlerë vetëm në Gjykatë në rast të ndonjë problemi apo diçka të tillë, e ka njoftuar L.Sh.n, se kjo kontratë nuk ka vullë, dhe për këtë rast kemi pas një debat me L.Sh. unë dhe ai,

momentin kur i ka treguar F.Sh. sepse kjo kontratë nuk ka vullë dhe vlerë ka vetë në Gjykatë në rast të ndonjë problemi. Pyetje: pse mendon L.Sh. se ju e keni mashtruar? Përgjigje: në asnjë moment nuk ka pas të bëjë me mashtrim por siç e cekta edhe më lartë me gjendjen time faktike i privuar nga Liria dhe me një Gjykim të parë i dënuar me burgim të përjetshëm këto marrëveshje që kanë qenë mes meje dhe palës pronarit F.R.1.t, për ta është krijuar mendimi se kanë qenë me një person thuajse i vdekur dhe shfrytëzimi i gjithë kësaj situatë ka ardhur si pasojë e mos tregimit të vërtetës tek L.Sh., prej anës së pronarit të objektit, unë gjatë momentit kur jam njoftuar se është një kallëzim ndaj meje nuk kam mundur assesi që të jap ndihmë për L.Sh.n që ky problem mos të vije deri këtu. Pyetje: ju thatë se nga L.Sh., keni marrë veturën dhe me paratë e cekura më lartë, çka keni bërë me paratë? Përgjigje: pasi që jemi marrë vesh me L.Sh. janë prezantuar në letër të gjitha marrëveshjet atëherë më është bërë dorëzimi i çelësave të veturës Audi dhe pjesa e parave prej 10.000 Euro më është dorëzuar nga nipi i tij me emrin D., e di që L.Sh. e ka ç' lajmëruar veturën në shtetin ku jeton në Gjermani, çka do të thotë ka sjell librezën e ç' lajmërimit, dhe unë nuk e kam bart në pronësi timen por e kam shitur veturën dhe atë ia kam shitur F.S.t dhe atë me ndërrim veture. Pyetje: a ka mundur ta merr në posedim L.Sh. banesën që e ka blerë nëse jo a e din arsyen? Përgjigje: unë e shpjegoja edhe më herët për shkak se prej fillimit kur është nisur asnjëherë nuk është nisur marrëveshja për ti bërë dëm apo mashtruar të dëmtuarin, por me arrestimin tim dhe mos gjendjes time në liri, atëherë kjo gjë është shfrytëzuar dhe ka ardhur situata siç është caktuar, po të isha unë në liri L.Sh., apo edhe kushdo tjetër të ishte në vendin e tij do ta kish pasur banesën siç ishte bërë marrëveshja. Pyetje: në bazë të dëshmisë që ka dhënë dëshmitari F.R.1., ka deklaruar se për këtë banesë nuk ka pas kurrfarë kontrate për shitblerjen, ka thënë se keni pas për dy të tjera por për këtë jo, pse ka dhënë këtë deklaratë pse e ka mohuar? Përgjigje: nga fillimi i rrjedhës gjyqësore kam kërkuar provat që gjenden në telefonin tim për arsye sepse kam dashur si F.R.n dhe dëshmitarët e tjerë të ju bëjë pyetje me prova konkrete dhe jo vetëm pyetje thjesht pa prova, por si të ishin provat që i kam kërkuar nga telefoni besoj me bindje të plotë se sot rrjedha gjyqësore do të ishte shumë më ndryshe.

Në pyetjet e parashtruara nga prokurori i shtetit Avdullah Abedini, i pandehuri T.L., është përgjigjur: Pyetje: a është e vërtetë se në vitin 2019 jeni takuar me L.Sh.n? Përgjigje: po. Pyetje: a është e vërtetë se të dëmtuarit L.Sh. në vitin 2019 i keni shitur banesën në Ferizaj, konkretisht në objektin banesor G.R. 2, në sipërfaqe prej 125,24m², me çmim të përgjithshëm prej 53.000 Euro, a është e vërtetë? Përgjigje: po. Pyetje: a është e vërtetë se keni pranuar nga i dëmtuari veturën e tipit Audi A6 dhe shumën e parave prej 10.000€? Përgjigje: po. Pyetje: a e keni pas këtë banesë në emrin tuaj para se ta kontraktoni këtë banesë ju në cilësinë e shitësit, ndërsa L.Sh. në cilësinë e blerësit? Përgjigje: siç e kam cekur edhe më herët unë kam pas marrëveshje vetëm me

F.R.1. dhe jo marrëveshje noteriale, por kam pasur të drejtë dhe marrëveshje me F.R.1. se për atë banesë ta shes, ta fal apo ta tjetërsojë sepse është cilësuar si pronë e imja. Pyetje: a është njoftuar nga ana juaj F.R.1. se do të ia shitni banesën L.Sh.t para se të hyni në marrëdhënie kontraktuale me L.Sh., dhe si ka qenë forma e njoftimit? Përgjigje: po e kam njoftuar, njëherë me telefon, edhe takim personal i kam treguar, por edhe siç kam cekur edhe më parë se në bazë të marrëveshjes sime me të e kam pas marrëveshjen se nëse obligimi në tërësi prej 10% obligim ndaj tij mbyllet, atëherë do kalojmë në kontratë noteriale. Pyetje: a mund të na tregosh se si kanë qenë procedurat ligjore me pas të drejtë që të i bëhet bartja e banesës këtë rast L.Sh.t, përmes kontratës te noteri? Përgjigje: kontratë te noteri për bartjen e banesës në pronësi, banesës konkrete autorizues është vetëm F.R.1.. Pyetje: a jeni në dijeni që L.Sh., blerësi- i dëmtuari ka shkuar te objektet te zyret e G.R.- F.R.1. me u interesua për banesën që ti ia ke shit? Përgjigje: unë e ceka edhe më herët që në prezencën time dhe të L.Sh., bashkëshortes së L.Sh.na e kemi vizitua objektin banesën, ku ishte në ndërtim e sipër dhe ka qenë prezent edhe F.R.1.. Pyetje: ku është lidhur kjo kontratë? Përgjigje: unë e ceka edhe më herët se kontrata është lidhur te avokatja E.Sh., ku i autorizuar ka qenë F.Sh.. Pyetje: çfarë dokumentacioni ke pas lidhur me banesën? Përgjigje: planin e banesës, edhe marrëveshjen me shkrim me F.R.1.n. Pyetje: kopjen e planit prej kujt e ke marr? Përgjigje: F.R.1.t. Pyetje: a ka mbajt evidencë i autorizuari i avokates F.Sh.? Përgjigje: nuk e di nuk e kam vërejtur, nuk kam dijeni. Pyetje: a është e vërtetë që shumën prej 10.000 Euro dhe veturën a i keni marrë? Përgjigje: po. Pyetje: a je në dijeni se a i ka kaluar në emrin e L.Sh.t banesa që ti ke shitur? Përgjigje: po të ishte bërë bartja unë do të kisha qenë këtu në gjykatë hiq. Pyetje: a e ke kompensua L.Sh.n me paratë? Përgjigje: jo.

Në pyetjet e parashtruara nga përfaqësuesit të të dëmtuarit L.Sh., av. Avni Ibrahim, i pandehuri T.L. është prgjegjur: Pyetje: ju deklaruar deh u përgjigjët në pyetjen e mbrojtëses tënde se me F.R.1. ke pas një marrëveshje për blerjen e banesave në formë të shkruar, a është e saktë?

Përgjigje: po dhe për shkak të kësaj saktësie dhe provave që gjenden sot telefoni im nuk është i qasshëm për nxjerrjen e atyre provave dhe me sjelljen e raportit të forenzikës së fundit më dëshmon me bindjen e plotë sepse një raport që sillet deri në vitin 2018 kur rasti për të cilin akuzohem ka ndodhur në vitin 2019 dhe për këtë kohë nuk është asnjë e dhënë nga telefoni im. Pyetje: a të kujtohet që kjo marrëveshje me F.R.1. a të kujtohet viti dhe muaji kur e ke nënshkruar? Përgjigje: viti ka qenë 2019, ndërsa muaji nuk më kujtohet saktë, por ka qenë pranverë. Pyetje: në kontratë a kanë qenë të evidentuara një objekt apo më shumë banesa? Përgjigje: për secilën banesë veç e veç ka qenë marrëveshja. Pyetje: a të kujtohet në cilin objekt ka qenë, në cilin kat dhe sa ka pas sipërfaqe? Përgjigje: ashtu siç përshkruhet në kontratë është e njëjta. Pyetje: në akuzë dhe në kontratë shkruan se kati është i 5 sipërfaqja është 125,24 m2,

mirëpo në atë objekt në atë kat nuk ka banesë me sipërfaqen të cilën është e shkruar në kontratë?
Përgjigje: nuk më kujtohet.

Mbrojtja e të akuzuarit F.Sh.

F.Sh. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor me datën 02.11.2023, në pyetjet e parashtruara nga mbrojtësit së të pandehurit av. Burhan Qosa, i pandehuri T.L. është përgjigjur: Pyetje: personin me emrin Dashnor a e keni njohur? Përgjigje: me sa më kujtohet këtë person e kam njohur diku 1 dit para se të përpilohet kontrata. Pyetje: a është e vërtetë se me Dashnorin dhe 6 persona të tjerë familjar të L.Sh. dhe shokë tuaj, jeni takuar për të biseduar për shitblerjen e banesës në H.P.? Përgjigje: po pasi që aty është arrit dhe marrëveshja në prezencë të nipave të tij. Pyetje: ju thatë në pyetjen e prokurorit dhe avokates tuaj që gjatë marrëveshjes ju i keni prezantuar L.Sh. planin e banesës dhe marrëveshjen paraprake që e keni pas me investitorin G.R.- F.R.1.? Përgjigje: po. Pyetje: a mund të na thoni në takimin e H.P.it që keni qenë thujse mbi 10 vet a e keni prezantuar planin dhe marrëveshjen? Përgjigje: po saktë, çdo detaj është diskutuar me hollësi rreth banesës. Pyetje: a është e vërtetë që veturën Audi A6 e ke pranuar në H.P. ditën kur e keni bërë marrëveshjen, ndërsa çelësin dhe librezën e veturës e keni pranuar më vonë? Përgjigje: po. Pyetje: në H.P. siç e thatë se marrëveshjen e keni bërë para se me e bë kontratën objekt shqyrtimi, supozohet se keni qenë 10 persona, a ka qenë F.Sh. në mesin e juaj? Përgjigje: nuk ka qenë, e as që është diskutu në lidhje me të. Pyetje: ju thatë që kontratën e keni bërë tek zyra e avokates Edit, ndërsa përpilimin e ka bërë F.Sh. ? Përgjigje: po. Pyetje: ju po ashtu keni deklaruar se para se ta bani kontratën e keni njoftuar L.Sh. për shitblerjen e banesës nuk mund të lidhni kontratë te noteri? Përgjigje: po. Pyetje: ju keni deklaruar se edhe F.Sh. gjatë përpilimit të kontratës ju ka njoftuar se kontrata është vetëm një marrëveshje nëmës juve dhe nuk mund të vulozet dhe mund te shërbejë vetëm nëse keni ndonjë mos marrëveshje dhe atë ta paraqitni në Gjykatë? Përgjigje: po. Pyetje: a është e vërtetë se planin e banesës e keni mare nga investitori F.R.1. dhe të njëjtën ia keni prezantuar L.Sh.t. Përgjigje: po. Pyetje: a të kujtohet reagimi i palës L.Sh. dhe bashkëshortes së tij, kur ju ka njoftuar F.Sh. ... se kontrata është vetëm një marrëveshje dhe nuk mund të vulozet? Përgjigje: gjatë pyetjeve të avokates sime kam cekur se pas njoftimit të F.Sh.t, po ashtu edhe meje, se është marrëveshje një palëshe nuk ka vulë, nuk kam pas në diskutim, jashtë prezencës së F.Sh.t, me palën e lartë cekur- L.Sh., ku kemi rënë dakord që të i hedhim firmat- nënshkrimet në këtë kontratë. Pyetje: a ju kujtohet a keni bërë kontratë të natyrës së tillë te zyra e avokates E.Sh.? Përgjigje: po kam pas kontrata që kemi përpiluar tek zyra e saj dhe kam qenë disa herë edhe për kontrata edhe për punë. Pyetje: a ke pas rast për të bërë kontratë te zyrja e avokates E.Sh. për banesat e tjera? Përgjigje: po kam pas kontratë edhe për

banesat e tjera, por edhe shkëputje apo anulim kontrate, por me emër nuk më kujtohet? Pyetje: a të kujtohet a ke bërë kontratë me blerësin Sh.E.? Përgjigje: po. Pyetje: a të kujtohet a e keni shpërblye F.Sh.in, a e ke pagua? Përgjigje: po kam paguar në bazë të punës që e ka kryer në zyrën e tij.

Në pyetjet e parashtruar nga gjyqtari i vetëm gjykues i pandehuri T.L. është përgjigjur se në emrin tim nuk kam asnjë pasuri, as të holla e as patundshmëri, e njoftoj Gjykatën se unë kam jetuar me banim me qira, kërkoj nga Gjykata që të merr parasysht gjendjen time faktike si dhe çdo deklaratë që e kam dhënë gjatë seancave gjyqësore në gjykatë.

Në pyetjet e mbrojtësit së të pandehurit F.Sh., av. Burhan Qosa, i pandehuri F.Sh., përgjigjet: unë siç po më pyetni gjatë vitit 2019 kam punuar si praktikant në zyrën e avokates E.Sh., koha kur e kam filluar praktikën ka qenë fillimi muajit shkurt 2019 dhe praktika ka zgjat për një vit. Në kohën kur e kam kryer praktikën tek zyra e avokates kam qenë edhe i regjistruar edhe në Odën e Avokatëve ku ekziston kartela e praktikantit si dhe kam qenë i regjistruar në Odë. Pyetje: a të kujtohet në kohën kur ke punuar në zyrën e avokates E.Sh. se a ke përpiluar kontratë për shitblerjen e paluajtshmërive? Përgjigje: me aq sa më kujtohet së bashku me avokaten E.Sh. kemi përpiluar kontrata të shitblerjes së paluajtshmërisë. Pyetje: a ju kujtohet si praktikant formati formular për shitblerjen e banesave që e keni pas në kompjuterin? Përgjigje: po. Pyetje: me lejen e Gjykatës i mbrojturi i ofron në shikim një kontratë dhe a ka dal nga zyra ku ka bërë praktikën i pandehuri? Përgjigje: me sa unë pash dhe e lexova, formatin e saj e njëjta është e ngjashme me kontratat të cilat i ka leshu avokatja Edit. Pyetje: a të kujtohet në muajin gusht 2019 a keni qenë në Kosovë? Përgjigje: nuk e di saktë pasi që ka kaluar një kohë e gjatë por me sa e di po. Pyetje: a ju kujtohet a keni qenë praktikant në zyrën e avokates E.Sh.? Përgjigje: po, në vitin 2019 kam qenë si praktikant në zyrën e avokates E.Sh.. Pyetje: a e njihni T.L.n? Përgjigje: po. Pyetje: me datën 17.08.2019, a ju kujtohet a ka ardh në zyrën tuaj T.L. me kërkesën për të përpiluar kontratë për shitblerjen e banesës? Përgjigje: saktë data nuk më kujtohet por i njëjti T.L. ka qenë shpesh në zyrën e avokates për të marrë këshilla juridike dhe për të përpiluar kontratë apo akte të tjera. Pyetje: a do të thotë kjo se zyra ku keni qenë praktikant ka përpiluar edhe kontratë atë tjera për personin T.L.? Përgjigje: po Pyetje: me datë 12.12.2019, T.L. është arrestuar, për kohën sa keni qenë praktikant në raport me kontratat që janë dal nga zyra juaj për T.L.n, në kohën sa ka qenë në liri T.L., a ka pas ndonjë rast kur ndonjëra nga palët por edhe L.Sh. të ketë ardh tek zyra juaj që të paraqes vërejtje për T.L.n? Përgjigje: me aq sa më kujtohet jo. Pyetje: sa ka qenë T.L. në liri a teka marrë ndokush në pyetje që ka paraqitur ndonjë rast? Përgjigje: jo. Pyetje: a të kujtohet se pala e dëmtuar L.Sh. dhe T.L. janë ardh tek ju dhe kanë hartuar kontratë dhe a e keni

hartuar ju kontratën mbi shitblerjen e banesës? Përgjigje: nuk më kujtohet shumë mirë si rast specifik por edhe mund të jetë përpiluar nga ana ime. Pyetje: kontrata i ka 7 faqe, ai keni dhënë që të lexohet kontrata apo ia keni lexuar? Përgjigje: duke u bazuar në eksperiencat që i ka pas me avokaten E.Sh., çdo kontratë i është lexuar palëve në tërësi, mirëpo e njëjta edhe i është ofruar aleve fizikisht për lexim. Pyetje: në faqen 6 të kontratës evidentohet qartë sepaleve iu është bërë me dije se lidhur me shitblerjen, kontratën bazë duhet ta lidhin tek noteri, a ju kujtohet a ja keni lexuar këtë pjesë? Përgjigje: ashtu siç e thash edhe më herët çdo kontratë i është lexuar palëve në tërësi, një rrethanë e tillë është aplikua edhe për kontratën që më është prezantua. Pyetje: a mund të i thoni Gjykatës nëse e keni taku L.Sh. pas lidhjes së kontratës, cila kohë ka qenë, ku ke qenë ti? Përgjigje: saktë data nuk më kujtohet por ka mund me qenë muaji i fundit i viti 2019, kur i njëjti ka qenë në shtëpinë time. Pyetje: a ka qenë te zyra juaj para se ë vijë në shtëpinë tuaj? Përgjigje: jo. Pyetje: si të është prezantuar L.Sh. kur ka ardhur në shtëpinë tuaj? Përgjigje: kur ka ardhur i njëjti në shtëpinë time unë kam qenë fjet në atë kohë dhe mua më kanë thirr familjarët, pastaj i njëjti më është drejtuar në emrin tim. Pyetje: kush ka qenë përveç teje në shtëpi? Përgjigje: gjyshja ime, prindërit dhe më pas kanë ardh edhe axha im S.Sh.. Pyetje: sa i keni shtëpitë larg me axhën Përgjigje: ndërmjet kemi dy shtëpi, me ecje rreth 1-2 minuta. Pyetje: ju thatë se S.Sh. ka ardh më pas në shtëpi, çfarë profesioni ka S.? Përgjigje: është noter. Pyetje: a është e vërtetë se L.Sh. ka ardh direkt në shtëpinë tuaj? Përgjigje: po. Pyetje: a ka ndonjë tjetër noter me emrin S.Sh. apo vetëm me mbiemër Sh.? Përgjigje: me sa e di unë jo. Pyetje: a ka ndonjë noter tjetër kushëri në afërsi të gjakut? Përgjigje: jo.

Në pyetjet e parashtruara nga prokurori i shtetit Avdullah Abedini, i pandehuri F.Sh. deklaron: Pyetje: a keni punuar tek noteri S.Sh., ndonjëherë? Përgjigje: po. Pyetje: në cilin vit keni punuar? Përgjigje: unë kam punuar deri në vitet 2015, 2016 deri 2018. Pyetje: gjatë vitit 2019 a ke punuar? Përgjigje: jo. Pyetje: në pyetjen e mbrojtësit tuaj lidhur me kontratën e shitblerjes së banesës e cila është objekt i kësaj akuze ndërsa palët kontraktuese janë T.L. si shitës në njërin anë dhe L.Sh., si blerës në anën tjetër, kur kanë ardh në zyrën e avokates kush kanë qenë? Përgjigje: nuk më kujtohet kontrata, por nuk më kujtohet mirë se kush ka qenë si gjithmonë kanë prezantuar dy palë shitësi dhe blerësi. Pyetje: para se me përpilua kontratën çfarë dokumentacioni ka prezantuar shitësi? Përgjigje: nga dokumentacioni që është prezantuar për përpilimin e kontratave të tilla palët kanë prezantuar skicë ndonjë shënim të banesës apo paluajtshmëriëve dhe ndonjë dokument tjetër relevant që mund të lidhet kontrata. Pyetje: a keni përpilua edhe ndonjë kontratë tjetër lidhur me banesat te objekti g.r.? Përgjigje: nuk më kujtohet, pasi që ka pas kontrata të objekteve të ndryshme. Pyetje: ju thatë se ka ardh L.Sh. tek shtëpia juaj?

Përgjigje: po. Pyetje: cila ka qenë arsyeja që ai ka ardh te shpie juaj? Përgjigje: me aq sa më kujtohet gjatë bisedës që është zhvilluar i njëjti ka ardh për një kontratë që ka pas me T.L.n. Pyetje: a ju ka thënë se kjo kontratë është lidhur në zyrën e avokatit ku keni punuar? Përgjigje: nuk më kujtohet mirë bisedën që ai e ka zhvilluar. Pyetje: a e pyetët se pse keni ardh tek unë? Përgjigje: po e kemi pyetur, pasi që familjarët e mi kanë qenë aty dhe kanë zhvilluar bisedën me të, pastaj jam dalë unë e kam pyetur edhe unë dhe ka thënë se ka ardh për një kontratë të shitblerjes me T.L., i njëjti më është drejtua se kontratën e kam përpiluar unë. Pyetje: a kërkoi ndonjë sqarim? Përgjigje: i njëjti ka kërkuar ndihmë se çfarë veprime të ndërmarrë tutje dhe e kemi udhëzua që të drejtohet në organet e drejtësisë Pyetje: a ke pas ndonjë rast që ke përpilua ndonjë kontratë të banesës ku ka qenë shitës T.L.? Përgjigje: nuk më kujtohet mirë por ka gjasa që të kem përpilua edhe kontrata të tjera. Pyetje: çfarë dokumentacioni ka paraqitur? Përgjigje: dokumentacioni për kontrata e kanë prezantuar palët ? Pyetje: a ju kujtohet koha prej momentit kur është përpiluar kontrata dhe ardhja deri te shtëpia juaj? Përgjigje: nuk më kujtohet shumë saktë por bazuar datën e kontratës që është cekur gjatë kësaj seancë i bie që të jetë rreth 5 muaj. Pyetje: pasi qe ka ardhur L.Sh., të sqaroj lidhur me këtë kontratë që e kemi përpiluar a keni provuar të kontaktoni me T.L. Para se të përgjigjet i pandehuri F.Sh. ... nga prokurori i shtetit mbrojtësi i tij avokati Burhan Qosa kërkon te merr fjalën gjyqtari gjykues i jep te drejtën Konsiderojmë se pyetje është jo objektive per faktin se: 1. Prokuroria Themelore në Ferizaj është në dijeni se T.L. me date 12.12.2019 ,ka qenë i ndaluar dhe kontakti me te ka qene i pa mundur ne raport me dyshimin qe ka qene i ndalur. 2. Edhe Prokurori i çështjes me këtë shqyrtim u njoftua nga vetë T.L., me datë 12.12.2019 ka qenë i arrestuar të njëjtin i është konfiskuar po at dit telefoni.3. Ne pyetjen time te F.Sh. . se a ka pas ndonjë herë ndonjë rast ku palët që kanë lidhur kontratë me T.L.n në zyrën e Av. E. te jene te paraqitur para juve, para datës 12.12.2019, me pretekstin se kanë probleme me T.L.n lidhur me kontratat qe i kanë përpiluar në këto rrethana. Duke qenë e dikur se pala e dëmtuar edhe nga gjitha shkresat e lëndës ka deklaruar se problemi lidhur me banesën objekt shqyrtimi ka lindur pas arrestimit të T.L.t dhe pyetja e parashtruar nga prokurori i shtetit se ka provuar klienti im ta kontaktoj T.L.n, për ti ndihmuar Përgjigje: jo. Pyetje: Gjatë kohës sa e qenë ti praktikant te Av. E.Sh., a ka pas rast me ardhur palët për kontrata se kanë probleme. Përgjigje: Nuk me kujtohet pasi qe rastet te tilla është kompetent e avokates që të bisedoj me to, edhe pas këtij rasti nuk ka pas rast qe te vie dikush ne shtëpi. Në rimarrje ne pyetje te pandehurit Av. Burhan Qosa, ku gjykata i lejon. Pyetje: A te kujtohet lidhur me këtë çështje sa herë ke deklarua dhe ku? Përgjigje: Lidhur me këtë çështje jam deklarua një herë në polici me ftesën qe me është bere nga policia për të deklaruar si dëshmitar me një rast. Ne pyetjen e gjyqtarit gjykues. Deklaron se tani jam duke punuar ne zyrën e Noterit S.Sh. ,si zyrtar ligjor dhe

kam kontratë pune. Sa i përket pyetjeve që po i përjashtoni se i dëmtuar që ceket në aktakuzë i njëjti nuk është takuar asnjëherë me mua në zyrën e noterit po ashtu edhe jashtë zyrës.

Vlerësimi dhe analizimi i provave dhe vërtetimi i gjendjes faktike

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, gjykata komfor nenit 7 dhe 360 par.1 dhe 2 të KPP-së të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarve si dhe ato në favor të tyre duke i mundësuar të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç'rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka arritur në përfundim se deklaratave të dëmtuarit L.Sh., dëshmitares K.Sh., dëshmitarit D.A., Dhe provave materiale të latrë cekura duhet ti falet besimi ngase të njëjtat janë në harmoni edhe me provat e tjera personale dhe materiale plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike në dispozitiv të aktgjykimit.

Pas administrimit të provave të lartë cekura të njëjtat i analizoi dhe vërtetoi se pretendimet e mbrojtëses së të akuzuarit T.L., dhe mbrojtëses sëë tij av. Latife Neziri të dhëna në fjalën përfundimtare për pikë 6 e parë të kësaj aktakuzës, dhe pretendimet e mbrojtëses së të akuzuarit F.Sh. dhe mbajtësit të tij av. Burhan Qosa në fjalën përfundimtare për pikën e dytë të kësaj aktakuze të njëjtave mbrojtje nuk ia fali besimin, pasi që mbrojtja e tyre ka për qëllim të shmangët përgjegjësisë juridiko-penale, që akuzohen të akuzuarit veç e veç për veprat penale të mashtrimit, dhe se mbrojtja e tyre është në kundërshtim të plotë me provat materiale dhe personale të lartë cekura të cilat janë administruar në shqyrtimet gjyqësor, gjykata i dha besimin e plotë, ndërsa pretendimet e mbrojtëses së të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre i hodhi poshtë si të pa besueshme, andaj gjykata të akuzuarit veç e veç i shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, duke e vërtetuar në tërësi përgjegjësinë e tyre penale-juridike, pasi që nuk është gjetur asnjë rrethane e cila e përjashton përgjegjësinë e tyre eventuale.

- *Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit Trimor Llalincovi Mashtrim nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në pikën të përshkruar si në pikën e I-rë dispozitivin e aktgjykimit.*

- *Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit F.Sh.,*

manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale mashtrimi, nga neni 323 paragrafi 1 të KPRK, e II-të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e caktimit të dënimit ndaj të akuzuarit t.l., gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69,70,71, dhe 72 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, duke gjetur si rrethane posaçërisht rënduese, shkalla e përgjegjësisë penale, motivi dhe dashja si element qenësor i kryerjes së veprës penale të mashtrimit-përfitim të kundërligjshëm pasuror për vete, duke i shkaktuar dëm material personit tjetër, rrethanat e kryerjes së veprës penale, nga e kaluara e tije kriminale është i gjykuar dhe në vuajtje të dënimit për kryerjen e veprës penale vrasja e rëndë nga nenin 173 par 1 nën par 1.4 dhe 1.6 të KPRK-së dhe Veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së dyshuar për disa vepra penale, në kuptim të nenit 70,71, 72 të KPRK-së, e si rrethana lehtësuese gjykata mori, gjatë shqyrtimeve gjyqësor ka pasur sjellje dhe qëndrim tejet korrekt, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion të plotë me shkallën e përgjegjësisë penale-juridike të të akuzuarit, andaj ky dënimi shqiptuar do të ndikojë te i akuzuari që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm, dhe do të përmbahet nga veprimet, e tilla të karakterit juridiko-penal, dhe me këtë edhe do të arrihet qëllimi i dënimit në risocializimin e të akuzuarit në shoqëri.

Me rastin e caktimit të dënimit ndaj të akuzuarit F.Sh., mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë lehtësuese mori sjelljeje korrekte gjatë gjykimit është hera e parë që ndeshet me ligjin, mbajtës i familjes ndërsa rrethana rënduese gjykata mori për bazë shkallën përgjegjësisë penale të akuzuarit, si dhe shkallën e dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar. Gjukata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të njëjtit i shqiptoj dënimin me gjobë dhe me burgim e të kushtëzuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ku Gjukata me këtë dënim konsideron se i akuzuari e ka kuptuar rëndësinë e veprimeve të dëmshme dhe mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtari është i bindur se dënimi i shqiptuar me gjobë dhe me burgim e i kushtëzuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarit, kështu gjykata vlerëson se me shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e veprës penale

dhe të kryesit, po ashtu ky dënim do të shërbej në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale), si dhe do të arrihet qëllimi që t'i përmbaj edhe personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi për kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për pjesën e mbetur të dëmit që i;u është shkaktuar realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë në pajtim me nenin 462 par. 1. dhe 2. të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).

Vendimi për kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nen par 2.9 të KPP-së dhe në kuptim të nenit 36 parag.3 pika 3.1 të Ligjit me numër 08/L-109, ku thuhet “*për veprën penale që gjykohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore shuma është prej njëzet (20) Euro*”.

Ne kuptim të nenit 364, 365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.1097/2020 (2020:186771) me datë 05.2.2024

Zyrtare Ligjore
Arbelinda Tahiri

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.